

55

Adresa: Rruga
"Medar Shtylla",
qendra e biznesitTel: 04/2321364,
Tel: 04/2321366,
Fax:04/2321365,
Tiranë
E-mail:
info@gazeta55.net,
gazeta55mail@
yahoo.com,
Internet:
www.gazeta55.al
Çmimi 30 lekë
Greqi 1,5 EURO

DOSSIER 12/13

Katastrofa e arkivave të shtetit shqiptar në vitet 1944-1964

Raporti i vitit 1961: Arkivat rrezikohen të zhduken

Nga Kastriot Dervishi

Këshilli i Ministrave konstatonte se fondi arkivor ishte dëmtuar rëndë fizikisht, mungonin godinat, kuadri i përshtatshëm, mjetet teknike, etj, problematika që hasen edhe sot në të njëjtat përmasa

RAMA-TAHIRI, përgjues dhe mashtrues

Parada e dëshmive të institucioneve në komisionin e sigurisë konfirmoi denoncimin se dyshja kanabiste Rama-Tahiri, është jo vetëm dyshe e sëmurë pas përgjimit, por edhe e fiksuar pas mashtrimit. Tezat për përfshirjen e ndërkombëtarëve në abuzimin e tyre kushtetues, pengimi i institucionit të akuzës për të kryer hetimin dhe fushata për të përbaltur institucionin e Presidentit si dhe SHISH-in, skemë për t'iu shmangur vënies para përgjegjësisë. Dyshja përgjuese dhe mashtruese duhet të shkojë sa më shpejt në gjykatë, përndryshe papërgjegjshmëria mund të sjellë një largim më të dhimbshëm të tyre nga skena politike

DITA

Opozita ofron vizionin e saj për reformën në drejtësi, në përputhje me rekomandimet e "Venecias"

Kreu i opozitës Lulzim Basha njoftoi dje se në fillimjavë Partia Demokratike do paraqesë një draft propozimesh, bazuar në rekomandimet e Venecias, për të nisur dialogun politik, që mazhoranca po e mban të bllokuar. "S'jemi për një sistem drejtësie që i gjen punë Sadushit, Ibrahimit apo Xhafajt, tha kreu i PD, s'jemi për një sistem bipartizan, por për një sistem jopartizan"

Basha: PD kundër një reforme në Drejtësi që punëson njerëz politikë me rroga të majme



DITA

Thirrjet raciste të Erion Veliajt Or ti çuni nga Paraspuari, kur u bërë "qytetar i madh"?

Nga Dane Pelo

Nuk është ndonjë sekret i madh apo gjë e paditur të themi se regjimi komunist e ndërtoi pushtetin e vet mbi urretjen klasore dhe dasinë veri-jug...



FORUM

Administrata amerikane autorizohet që ta përgatisë Kosovën për Partneritetin me NATO-n

Në 90-vjetorin e lindjes së tenorit të mirënjohur "Mjeshtërit të Madh" Kristaq Paspali (1926-2016)

Tenori shqiptar i teatrit "Balshoi"

Nga Flori Slatina

**Basha: Largimi i Tahirit dhe i
Haki Çakos, parakusht për hetim
të paanshëm e të pandikuar**

**Berisha: Manjaku Edvin Shullazi
e ka siguruar në rrugë private e
antiligjore pajisjen përgjuese**

**A do ta mbrojnë Erion Velinë poturet
e Edvinit nga shkelja e kushtetutës
dhe fyerjet ndaj qytetarëve?**

Nga Sejdi Peka

**Garda e Rosisë si trupë
policore e vetë Putinit**

Presidenti Putin ka nisur një reformë të madhe policore. Garda e re do të jetë në varësi personale të presidentit. Vëzhguesit spekulojnë nëse ajo do të përdoret kundër terrorizmit apo kundër opozitës?

Fëmija i revolucionit kulturor

Nga Ma Jian
(Project Syndicate)

Opozita ofron vizionin e saj për reformën në drejtësi, në përputhje me rekomandimet e "Venecias"

Kreu i opozitës Lulzim Basha njoftoi dje se në fillimjavë Partia Demokratike do paraqesë një draft propozimesh, bazuar në rekomandimet e Venecias, për të nisur dialogun politik, që mazhoranca po e mban të bllokuar. "S'jemi për një sistem drejtësie që i gjen punë Sadushit, Ibrahimit apo Xhafajt, tha kreu i PD, s'jemi për një sistem bipartizan, por për një sistem jopartizan"

Basha: PD kundër një reforme në Drejtësi që punëson njerëz politikë me rroga të majme

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha deklaroi se drafti i opozitës për reformën në Drejtësi është sipas rekomandimeve të Venecias, duke u dhënë shqiptarëve një sistem drejtësie të pavarur. Pas përfundimit të mbledhjes së grupit parlamentar të PD-së, Basha u shpreh se ky draft do të jetë bazë e negociatave me PS dhe LSI në procesin e finalizimit të reformës së shumëpritur të drejtësisë. I pyetur nga media, nëse me këtë draft po rrëzohet arkitektura e drejtësisë, e cila edhe sipas Venecias nuk duhej prekur, Basha iu përgjigj që të mos keqinterpretohet ç'ka thënë Venecia, nëse Xhafajt ka thënë se kemi 12 persona që duhen paguar sa presidenti dhe 7 të tjerë që paguhen me rroga të majme, kjo nuk bëhet. Kreu i opozitës u shpreh se nëse duan t'i gjejnë vend pune Sadushit, Ibrahimit, Xhafajt apo edhe Alibeajt, atëherë bëjmë reformë që t'u gjejnë punë këtyre me rroga të majme. Kreu demokrat u ndal edhe tek çështja e përgjimeve, ndërsa përsëriti kërkesën e opozitës për të bërë transparencë rreth kësaj çështje dhe se largimi i ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, është parakusht për hetimin e saj. "Partia Demokratike tashmë është shprehur qartë dhe prerë pro krijimit të strukturave të posaçme antikorrupsion, SPAK-ut, BKH-së, apo siç quhet tani njësisë hetimore të posaçme dhe natyrisht edhe pro procesit të verifikimit të integritetit të figurës së gjyqtarëve e prokurorëve apo siç njihet në anglisht procesit të "Vetingut". Për pjesën e sistemit ku "Venecia" ka thënë qartë që palët politike duhet të gjejnë gjuhën e përbashkët për t'i ofruar shqiptarëve zgjidhje të standardit evropian, Partia Demokratike ka tashmë një draft të konsoliduar, që u është prezantuar parlamentarëve. Dhe javën e ardhshme pas një diskutimi në grupin parlamentar të rakorduar plotësisht, ky draft do të përbëjë edhe bazën



e negociatave tona me Partinë Socialiste, me Lëvizjen Socialiste për Integrim në procesin e finalizimit të diskutimit të draftit kushtetues për Reformën në Drejtësi", tha Basha.

Pse duhet një draft paralel z. Basha kur është rënë dakord që baza e reformës në drejtësi të jetë drafti i dy ekspertëve të OPDAT dhe EURALIUS?

Konstatimi i dytë është i gabuar. Vetë ekspertët kanë shkruar të kuqe mbi të bardhë që këtu ka një sërë çështjesh politike që kërkojnë rakordim politik. Dhe për ta bërë procesin transparent dhe për të mos e lënë pre të keq informimit të publikut, sa me dashje nga ata që e kanë vonuar me të vërtetë reformën për dy vite me radhë e sa pa dashje nga ata që nuk e dinë se çfarë është reforma. Opozita për këtë pjesë të kuqe mbi të bardhë, për zgjidhjet politike, po ofron vizionin e saj në përputhje me rekomandimet e "Venecias". Në fakt i takonte mazhorancës ta bënte, nuk e ka bërë. Arsyet përse nuk e ka bërë është më mirë të mos i paragjykojmë meqë kërkojmë dialog me ta. Por opozita edhe kësaj radhe po tregon se ka kredibilitetin dhe vullnetin për të ecur përpara me reformën. I takonte mazhorancës t'i kishte hedhur këto hapa. Po i hedhim ne këto hapa edhe në raport me komponentin anti korrupsion. Ata sollën një

reformë të orientuar nga kapja politike e sistemit me Saimir Tahirin nën një shtetull me pajisje përgjimi dhe nën shtetull tjetër BKH-në. Ne e sollëm në një reformë standard, pra e hoqëm zvarrë nga duart e atyre që donin ta kapnin sistemin e sollëm këtu por ka nevojë për përmirësime të tjera. Po ku në fund të fundit kemi një sistem që i shërben qytetarëve, jo politikanëve, i shërben qytetarëve dhe jo politikës. Qytetarët kanë nevojë për një gjyqësor të pastër nga korrupsioni, për një prokurori të pastër nga korrupsioni që heton dhe vë para përgjegjësisë penale apo para përgjegjësisë civile shkelësit e ligjit sipas ligjit. Dhe jo sipas porosive të Edi Ramës, apo të Ilir Metës, jo sipas pasurisë apo influencës të Klement Balilajt, apo të Habilajt, apo të Emiljano Shullazit por sipas ligjit. Ky është thelbi i reformës në drejtësi dhe Partia Demokratike, në fakt nuk dua të flas për veten time, por ekspertët tanë meritojnë dhe sot kanë përgëzimin tim maksimal që edhe në këtë hap ne jemi përpara mazhorancës. Po shkojmë me një draft për atë që na kërkohet nga "Venecia", nga komuniteti ndërkombëtar, zgjidhjet politike për strukturën e sistemit.

Zoti Basha sa i takon strukturës, Partia Demokratike kërkon

thjeshtëzim të arkitekturës së sistemit të drejtësisë me heqjen e të paktën tre institucioneve. A rrëzohet kështu reforma në drejtësi, PS ka thënë që në fillim se arkitektura e drejtësisë nuk preket? E ka thënë edhe "Venecia"

Jeni të keqinformuar kur citoni "Venecian", duhet të kini pak më shumë informacion. Ju takon të kini më shumë informacion kur citoni një nga organet më superiore të drejtësisë në Evropë siç është "Venecia". "Venecia" e ka thënë e para që sistemi është tepër i komplikuar dhe duke qenë kaq i komplikuar kemi dyshime se mund të qëndrojë në këmbë dhe se Shqipëria ka kapacitetin e mjaftueshme ta mbajë në këmbë. Pas kësaj thotë që ne takuam Fatmir Xhafën dhe Fatmir Xhafa siguroi që në Shqipëri ka mjaftueshëm njerëz që sistemi të qëndrojë në këmbë dhe ne jemi të përgatitur të pranojmë një sistem të tillë, në qoftë se palët bien dakord. Mos ta harrojmë këtë pjesë të rëndësishme. Po tani në qoftë se Fatmir Xhafa ka thënë që ne kemi 12 persona që do t'i paguajmë sa Presidenti i Republikës dhe shtatë të tjerë që do t'i paguajmë dy herë sa Kryeministri për të bërë gjyqtarin e gjyqtarëve, kur shqiptarët kanë 25 vite tranzicion që shohin se ne mezi gjejmë anëtarët e përshtatshëm për Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë atëherë kjo s'kërkon një analizë të thellë akademike, ligjore e politike. Shqiptarët e dinë që ne vuajmë për kapacitete të tilla. Kush janë këta 12 fatosa dhe 7 pionierë që do marrin përsipër?! Arkitektura e sistemit mund dhe duhet të thjeshtohet për t'i shërbyer sistemit, për t'i shërbyer qytetarëve. Ne ecim me propozime të cilat i shërbejnë qytetarëve. Në qoftë se duam t'i gjejnë vend pune Sokol Sadushit, Genti Ibrahimit, Ardian Dvoranit, Kristaq Trajës, Fatmir Xhafës në qoftë se e ka ndërmend për nesër, Enkelejd Alibeaj në qoftë se ka aspiratë

të hyjë, atëherë hajde të bëjmë një reformë që t'i gjejnë punë 17 vetave me rrogë 6 milionë lekë në muaj. Por kjo nuk është Reformë në Drejtësi. Gjërat janë shumë të thjeshta dhe nuk duhet të fshihemi pas paragjytimeve. Partia Demokratike është futur me vullnet të pastër për t'i dhënë shqiptarëve një sistem drejtësie që funksionon. Jo një sistem drejtësie që punëson me rroga të majme njerëz politikë. Jo një sistem bipartizan, por një sistem jo partizan. Këto propozime sot kanë marrë formë të plotë dhe i ka marrë Grupi Parlamentar. Javën e ardhshme do të mbledhemi përsëri, si një parti e debatit të hapur, jo e misterit, si një parti e mendjes së hapur, jo e syve të mbyllur dhe dorën lart për diçka që nuk e ka lexuar njeri. Do diskutojmë. Një diskutim i cili po kështu do të jetë publik, do të ndahet me qytetarët. Do të ndahet edhe me ju gazetarët që edhe ju të keni mundësinë të gjykoni se çfarë zgjidhesh propozon Partia Demokratike dhe pse zgjidhjet tona funksionojnë. Sigurisht janë zgjidhje standard dhe janë zgjidhje, tek kjo këmbëngul, në përputhje me atë çfarë ka thënë Komisioni i Venecias.

Zoti Basha, thjeshtimi i arkitekturës, është kusht? Siç keni thënë për mos kapjen e sistemit?

Ne jemi në procesin e dialogut dhe nuk hyjmë me kushte. Ne hyjmë me një kërkesë. Të jemi të arsyeshëm dhe të zbatojmë standardin evropian dhe shpresojmë që edhe pala tjetër të ketë këtë vullnet. Sigurisht që për disa mund të jetë e dhimbshme, jua thashë. Për Saimirin mund të jetë e dhimbshme sepse nga njëra anë i hoqën BKH-në dhe nga ana tjetër i ka rënë dhe valixhja e përgjimit. **Po nëse mazhoranca nuk pranon?** Po pse të gjitha lajmet sot do t'i jepni. Shpresojmë që do të pranojë njëherë. Pastaj po nuk pranuan do të jemi përsëri këtu. Shpresojmë që t'i pranojnë. Të jemi pozitivë.

Çështja Balili/PD-ja e Delvinës: Qytetari Hamza Hamzai, dëshmitar i rremë që po përdoret nga Kokëdhima

Partia Demokratike në Delvinë deklaroi se ish-deputeti Koço Kokëdhima po përdor dëshmitarë të rremë për të fshehur lidhjen e tij me Klement Balilin, ish-drejtorin e Transportit të shpallur në

kërkim ndërkombëtar, si p.sh një person të quajtur Hamza Hamzai në foton lart, që e prezanton si kryetar të PD-së në këtë qytet. "Oligarku Koço Kokëdhima, i kapur në shkelje të ligjit nga Gjykata Kushtetuese,

ka fabrikuar sot në gazetën e tij një mashtrim ordiner, në përpjekje për të mbuluar lidhjet e tij të afërta e të drejtpërdrejta me Klement Balilajn, të shpallur në kërkim ndërkombëtar për trafik droge. Është pikërisht

Kokëdhima, për të cilin të gjithë në Sarandë e në Delvinë e dinë që i ka marrë para Balilajt për ta emëruar në krye të transportit rajonal, që nxjerr gënjeshtër të qëllimshme në gazetën e tij. Dega e Partisë Demokratike Delvinë

deklaroi se qytetari Hamza Hamza, që përdoret si dëshmitar i rremë nga Kokëdhima, jo vetëm nuk është pjesë e strukturave të PD Delvinë, por ishte në ballë të fushatës së mazhorancës së sotme në vitin 2013 e 2015.

Rama-Tahiri, përgjues dhe mashtrues

Parada e dëshmimeve të institucioneve në komisionin e sigurisë konfirmoi denoncimin se dyshja kanabiste Rama-Tahiri, është jo vetëm dyshe e sëmure pas përgjimit, por edhe e fiksuar pas mashtrimit. Ky çift përgjues përdhosi Komisionin e sigurisë duke tentuar të merrte nëpër këmbë një shtet të tërë. Skemat për përfshirjen e ndërkombëtarëve në abuzimin e tyre kushtetues, pengimi i institucionit të akuzës për të kryer hetimin dhe fushata për të përbaltur institucionin e Presidentit si dhe SHISH-in nuk kanë për të funksionuar, veçanërisht kur hetimi për këtë mega-afërë është shumë afër demaskimit të

së vërtetës, asaj të vërtete që siç është provuar nëpër botë, ka rrëzuar qeveri dhe jo shtete. Rama kërkon të rrëzojë shtetin, për të mbrojtur qeverinë e tij të kapur në flagrancë. Nuk na përgjua shteti, na ka përgjua Mili i Partisë, Arben Frroku, Armando Prenga, Elvis Roshi, Klement Balili, pra na kanë përgjua një grup njerëzish të inkriminuar. Skandali i përgjimeve përbën një atentat ndaj shtetit, një formë grusht-shteti ku një klikë kriminale e veshur si qeveri ka përgjua vetë shtetin dhe shoqërinë, përfshirë instanca të larta shtetërore, si Presidentin e Republikës, Kryeprokurorin, Opozitën dhe ambasadorët e huaj. Janë rreth 375



persona nga institucionet shtetërore, partitë politike, biznesi, media dhe bota artistike të përgjua prej 6 muajsh në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën. Më

shqeto, me përgjimin e kryeprokurorit apo prokurorëve të tjerë, krimi ka qenë gjithmonë një hap para shtetit. Përmasat e skandalit të përgjimeve s'mbulohen

dot më as me heshtjen e Edi Ramës, as me deklarimet e përçartura të Saimir Tahirit e as me garën e vartësve-policë, se kush të kandidohet si kokë turku për hetimin

e prokurorisë. Skandali po merr përmasa ndërkombëtare, sepse të papërgjegjshmit e koalicionit Rama-Tahiri, po bëjnë kurban edhe perspektivën e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, duke i ekspozuar në lojrat justifikuese që shqiptojnë në deklarimet publike. Mashtrimet e këtij skandali shihen edhe tek tentativat e Ramës dhe Tahirit për të bërë kurban marrëdhëniet mes Italisë dhe Shqipërisë, nëpërmjet justifikimeve se "na i sollën italianët pajisjen". Dyshja përgjuese dhe mashtruese duhet të shkojë sa më shpejt në gjykatë, përndryshe papërgjegjshmëria mund të sjellë një largim më të dhimbshëm të tyre nga skena politike

Skandali i përgjimeve/Mbahet komisioni i Sigurisë, Saimir Tahiri braktis me justifikimin "Kam punë"

Basha: Largimi i Tahirit dhe i Haki Çakos, parakusht për hetim të paanshëm e të pandikuar

Kreu i PD-së, Lulzim Basha deklaroi se vetëm largimi i Saimir Tahirit dhe Haki Çakos i hap rrugë një hetimi të plotë dhe të paanshëm. Pas mbledhjes së grupit parlamentar të PD-së, Basha theksoi se çdo investim i heshtur apo aktiv i Kryeministrit për të mos larguar Ministrin e Brendshëm dhe drejtues të policisë implikon Edi Ramën në këtë skandal. Basha tha se skandali do të zbardhet deri në fund dhe personat do të mbajnë përgjegjësi për shkeljen e ligjit. **Saimir Tahiri largohet pa dhënë përgjigje për skandalin e përgjimeve, justifikohet me "Kam punë të tjera"**/ Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, i cili ishte i thirrur në Komisionin e Sigurisë në lidhje me çështjen e pajisjes së përgjimeve e ka braktisur mbledhjen. Në momentin që kamerat e televizioneve nuk ishin në transmetim ministri Tahiri është ngritur dhe ka ikur. "Kam punë", ka qenë fjalja e Tahirit

thënë deputetëve, duke u larguar nga salla e mbledhjes së Komisionit të Sigurisë. Deputetët janë shprehur se Ministri i Brendshëm është larguar pa u përgjigjur pyetjeve që i ishin bërë. E gjitha kjo tregon frikën që e ka kapluar Tahirin, ndërsa përfshirja e tij në këtë krim shtetëror është padyshim fakt i kryer. Tahiri prej tre vitesh ka lidhur një aleancë të fuqishme me bandat, duke i dhënë imunitet dhe leje të pakufishme në marrjen e vendimeve. Tashmë janë bandat ato që vendosin për fatin e qytetarëve shqiptarë, ndërsa Rama-Tahiri e kanë të pamundur t'u largohen pasi, këto banda i sollën në pushtet. Që nga 'lazaratizimi', Shullazi, tritolet, përleshjet e deri tek skandali i përgjimeve. Të gjitha këto mbajnë emrin e Saimir Tahirit. **Visho Ajazi Lika i SHISH: IMSI Catcher u fut pa leje, cenon sigurinë kombëtare**/ Kreu i SHISH, Visho Ajazi Lika konfirmoi se pajisja përgjuese që u fut në

Shqipëri nga Ministria e Brendshme është IMSI Catcher. Në raportimin në Komisionin Parlamentar të Sigurisë, shefi i SHISH tha se pajisja përgjuese është futur në Shqipëri pa leje dhe shqetësimi ka qenë se mund të cenonte sigurinë kombëtare. "Dy muaj më parë SHISH u informua për futjen e kësaj pajisjeje në Shqipëri. Ishte problem se pajisja përgjuese kishte hyrë e padeklaruar në Shqipëri. I shqetësuar se mund të përdoret në mënyrë të jashtëligjshme, kërkova një takim dhe informova Prokurorin e Përgjithshëm për futjen e kësaj pajisjeje pa lejen e prokurorisë" ka thënë në Komisionin Parlamentar të Sigurisë, Visho Ajazi Lika. Pas informimit që ka bërë në prokurori, SHISH duket se e ka mbyllur misionin e tij. "Nuk jemi të interesuar të dimë si u përdor. I takon prokurorisë të hetojë më tej. Nuk kemi informacion kush u përgjua dhe pse u përgjua" tha Visho Ajazi Lika, duke shtuar se Prokurori i Përgjithshëm

u njoftua gojarisht dhe jo me shkrim. Sipas Visho Ajazi Likës, asnjë punonjësi i SHISH nuk ka pasur kontakt fizik me pajisjen dhe as nuk e ka parë atë. Sipas tij, funksioni i pajisjes, varet nga konfiguracioni i saj. Pajisja mund të zbulojë vetëm numrin e telefonit, apo edhe të dhënat që janë në telefon, tha kreu i SHISH. Kreu i SHISH, Visho Ajazi Lika, duke raportuar në Komisionin e Sigurisë, tha se pajisja e përgjimit që gjendet në Policinë e Shtetit është mjaft e fuqishme për të kryer të gjitha llojet e përgjimeve. Ai tha se një pajisje e tillë, që kishte hyrë dy muaj më parë përmes portit të Vlorës, do të ishte privilegj për të gjitha institucionet e inteligjencës. Ai sqaroi se nuk është në tagrin e Ministrit të Brendshëm të kryejë përgjime, por tha se nuk kishte dijeni nëse ajo ishte konfiguruar nga për të kryer përgjime. "Kjo është një pajisje e domosdoshme për të gjithë. Do të ishim të privilegjuar nëse do ta

kishim. Kur janë në dorë të organeve ato janë për të ndjekur shkelësit e ligjit. Nuk shoh ndonjë problem me trajnimin apo përdorimin, përderisa është ligjore. A përdoret për përgjim? Sigurisht pajisje të tjera janë mjaft të fuqishme. Por varet nga konfiguracioni. Sigurisht mund të jetë vetëm për gjurmim siç e ka thënë Ministri (Tahiri), por mund të jetë edhe për përgjim. Është krejt jashtë tagrit të Ministrit të Brendshëm të kryejë përgjime", u shpreh Visho Ajazi Lika. **Pajisja e përgjimit, Llalla kërcënon me ndjekje penale nëse pengohet hetimi**/ Pas drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, radha për të raportuar në Komisionin e Sigurisë Kombëtare është e kryeprokurorit Adriatik Llalla. Kreu i akuzës tha se për pajisjen e përgjimit në Policinë e Shtetit ka nisur tashmë një hetim. "Të nderuar anëtarë të komisionit, në përgjigje

të ftesës suaj jam përpara këtij komisioni për t'ju informuar se Prokuroria në bazë të informacionit, hetim që ka nisur me indicie se në territorin e Shqipërisë janë futur pajisje gjurmuese apo përgjuese, nën hijen e dyshimit i them të gjitha këto, sepse jemi në fazën e hetimit. Rasti për të cilin diskutohet, hetimi ka nisur pas informacioneve të SHISH-it, si edhe në bazë të dhënave mediatike dhe të dhënave të tjera. Hetimi me rastin ka tërësisht 5 ditë që ka filluar. Ne kemi kryer kërkime të rëndësishme hetimore. Prokuroria është angazhuar dhe ka ngritur një grup të posaçëm pune për të përfunduar në një kohë të shkurtër hetimet. Lidhur me përgjimet e viteve '90-të hetimet nuk janë përfunduar", tha Llalla. Kryeprokurori kërcënoi më tej me nisjen e procedimit penal edhe veprën penale të mos zbulimit të së vërtetës, nëse Prokuroria do të ketë pengesa nga qeveria apo zyrtarë të ndryshëm në këtë hetim.

Berisha: Manjaku Edvin Shullazi e ka siguruar në rrugë private e antiligjore pajisjen përgjuese

Ish-kryeministri Sali Berisha ka deklaruar se pajisja përgjuese është siguruar në rrugë antiligjore nga Edi Rama. Në një postim në facebook, ish kryeministri shkruan se një pajisje e tillë nuk mund të jetë asnjëherë pjesë e policisë nëse nuk është miratuar përkesa me shkrim prej prokurorisë.

Ish kryeministri i bën apel Prokurorisë që të nis hetimin rreth këtij skandali. "Burime të sigurta informojnë se pajisja me të cilën manjaku Edvin Shullazi, ka përgjua që nga fillimi i vitit kundërshtarët politik dhe të tjerë, ka hyrë në Shqipëri në mënyrë private në thyerje flagrante të ligjeve të vendit dhe marrëveshjes

ndërshtetërore me palën italiane, në kundërshtim me çdo destinacion ligjor dhe kushtetues të saj. Futja e pajisjeve të tilla në Shqipëri mund të bëhet vetëm në përputhje me ligjet e vendit dhe për destinacion të përcaktuar dhe të verifikueshëm qartë. Policia nuk mund të ketë kurrë një pajisje të tillë pa lejen me

shkrim të prokurorisë dhe për destinacionin e mirë përcaktuar po nga prokuroria, pra për personat apo grupin kriminal që përgjohet. I bëj thirrje prokurorisë së shtetit të bashkërendojë punën për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të këtij skandali të Edvin gait", shkruan Berisha. Më herët ish-kryeministri

Sali Berisha publikon mesazhin e një qytetari dixhital, ndërsa mësohet se pajisja e përgjimit është transferuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Akademinë e Rendit, duke u manipuluar gjatë natës. «Përsëritet doktor, një oficer pedagog në Akademinë e Rendit më thotë që pajisja e përgjimit që ka qenë në

Drejtorin e Përgjithshme e kanë sjellë mbrëmë natën tek Akademia e Rendit. Ndërkohë mediave u kanë thënë se është dorëzuar në ambasadën italiane gjë që është absolutisht e pavërtetë. Gjatë natës dy specialistë të drejtorisë së policisë kanë bërë ndërhyrje dhe fshirje dhe sot e ekspozuan si objekt mësimor për trajnim.

A do ta mbrojnë Erion Velinë poturet e Edvinit nga shkelja e kushtetutës dhe fyerjet ndaj qytetarëve

Nga Sejdi Peka

Nuk mundet që të besoj se ka mbetur qytetarë i Tiranës por edhe në të gjithë Shqipërinë që janë të bindur, se Erion Veliaj ka lajthitur në daljet e tij publike, duke sulmuar institucionet e vendit dhe fyerjet ndaj qytetarëve. Nuk preferoj që t'ju referohem rrjeteve sociale, por duket se Erion Veliaj po e sulmon institucionin e Presidentit të Republikës, duke menduar në paranojë e tij se ka një gjenezë de fakto, se dikush nga paraardhësit e tij ka arritur të bëhet Presidenti i një vendi dhe në këtë kontekst edhe ai ka të drejtën të bëhet "President", duke nxjerrë kokën nga poturet e Edi Ramës. Hajduti i "Mjaft-it" me emblemën e tij të një dore të përgjakur, shumë shpejt do të katapultonte në politikën shqiptare dhe pa asnjë kontribut do të hynte në elitën e Partisë Socialiste duke lënë shumë socialist të kësaj force politike me gishtin në gojë dhe të habitur. Marrëzria dhe deliri i madhështisë që e ka kapluar në të gjithë qënien e tij të një njeriu të painformuar, pervers dhe të pashkolluar, po e nxit gjithnjë e më tepër dhe çdo ditë që kalon, të shkelë ligjet, Kushtetutën e vendit dhe të fyejë qytetarët. Në kulmin e marrëzisë, ishte përballë gazetares së News 24 me dt 17 Maj, ku shfaqti gjithë mediokritetin e tij në raport me detyrën dhe marrëdhëniet me qytetarët. As një rrugaç ordiner, që nuk ka asnjë përgjegjësi morale dhe shoqërore, nuk mundet që të fyente publikisht Kryetarin e Shtetit se po citoj, "me



respekt ka një pastruese se Presidenti i Republikës". Kush mundet që të jetë kjo shëmtirë e shoqërisë shqiptare që të përfaqësojë në gjykimin e tij abstrakt, respektin që mundet që të kenë qytetarët e Shqipërisë për Presidentin e Republikës. Respekti ndaj institucioneve të shtetit dhe sidomos ndaj Presidentit të Republikës që është garant i Kushtetutës dhe Komandant i Forcave të Armatosura edhe në rastin kur cenohet integriteti dhe tërësia e Atdheut, përbën kushtin themelorë të një qytetari që e çmon lirinë dhe dashurinë për Shqipërinë tonë të vuajtur shumë. Çdo fyerje ndaj Presidentit të Republikës është një sjellje rrugaçerore dhe fyerje personale ndaj

çdo qytetari të Republikës së Shqipërisë dhe autorët e kësaj përjasje të turpshme duhen dërguar prapa hekurave për cenim të sigurisë tonë kombëtare. Erion Veliaj duket se po mendon në mediokritetin e tij, se do ta mbrojnë poturet e Edi Ramës nga përgjegjësia përpara ligjit dhe shkeljes së Kushtetutës, duke menduar se do të hyjë në hatrin e Edi Ramës, por gabohet rëndë. Kështu duket se mendoj edhe Koço Kokëdhima që mori revansh duke u krekosur "si Kryeministri i Jugut", por shumë shpejt i ranë pendët. Edi Rama e ndërseu dhe e ndërseu kundër demokracisë, por shumë shpejt e hodhi tutje si një limon të shtrydhur dhe kurrë më nuk do t'i

dëgjohe zëri, Koço do të mbetet në memorien e njerëzve si prototipi i hajdutërisë dhe makutërisë kundër Shqipërisë, si turpi i asaj që u quajt "Rilindje". Dhe nuk ka gjë më të shëmtuar e më të shpifur se një kaphosi që i bien pendët se lemeris dynjanë. Shumë herë gazetarja e mirënjohur e tërhoqi vëmendjen Erion Velisë për fjalët e kësaj "shëmtire mjaftiste" që i hidhte kuturë dhe pa kandar. Nuk kam dëgjuar, as kam parë, as lexuar gjatë të gjithë jetës time, se dikush mundet që të ketë deklaruar për personin e tij se ai "është një bishë". Kështu u shpreh ky i pataksuri që është zgjedhur Kryetar i Bashkisë së Tiranës në intervistën e News 24. Sado

në çfarë kuptimi mundet që të ketë bërë përpjekje për ta shprehur se gjoja ai na qenka "një bishë që mbron pronën publike", bisha është një shtazë, një kafshë mishngrënëse që shqyen dhe ushqehet me gjak të qënieve të tjera inferiore. Në këtë kuptim edhe kriminelët, vrasësit, ata që torturojnë ose kanë torturuar njerëzit për përfitime politike, grabitqare etj, quhen "bisha ose bisha me fytyrë njeriu". Dhe ja se për një kohë kaq të shkurtrë ai "Lali Eri" që i përfaqonte me aq "dashuri" fëmijët e përloçur të romëve, ai njeri aq "i dashur", shpejt na u kthye në një bishë me fytyrë njeriu. Ky Erion Veliaj "nuk pyet fare" as edhe për Kongresmenët Amerikanë që shqetësohen për veprimet e këtij skizofreni që sulmon institucionet e demokracisë në Shqipëri, Organet e Drejtësisë, se këta sipas tij na qenkan Kongresmenë të Partisë Republikane. Shikoni o njerëz të mire të Shqipërisë tonë çfarë keni zgjedhur për qytetar të parë të Tiranës? Po e bëjnë "lule" Shukri Xhelilin socialistët, këtë monstër të shëmtuar të "Rilindjes", krahasuar me këtë të budallallepsurin e Bashkisë së Tiranës! Po me qytetarët e Kamzës çfarë pati ky ditzi i "G99", që duke nxjerrë kokën nga poturet e Edi Ramës, duke shfaqur një racizëm të tejskajshëm kundër qytetarëve të këtij vendi i akuzoi në ballë të gjerë po citoj: -"Tiranasi nuk i honepsin dot njerëzit që vijnë nga Kamza dhe zbrasin me autobuzë në Tiranë, shkulin zgara metalike, pemë dhe puseta dhe pastaj ikin". Çfarë injorance e një njeriu të painformuar, të pashkolluar

dhe të përçarjes kombëtare. Por si mundet që të etiketosh qytetarët e Kamzës si hajdutë pusetash ose shkulësh pemësh që vijnë me autobus në Tiranë dhe sipas tij, përsëri me ato puseta e pemë të shkullura në krah udhëtojnë drejt Kamzës me autobus! Po në Kamëz ka qytetarë nga e gjithë Shqipëria ore i budallepsuri i "mjaftit" famëkeq. Po në Kamëz kemi njerëzit tanë, jemi ne qytetarë të Kamzës dhe nuk mundet që të lejojmë të na fyesh në dinjitetin tonë. Janë qytetarët e mirë dhe të traditës më të mirë të popullit tonë, qytetarët e Kamzës. Prandaj kur të zësh në gojë qytetarët e Kamzës, laje mirë atë gojën tënde të qelbur. Nëse je i revoltuar në zemrën tënde si katran i zi prej bolsheviku kundër demokracisë, se këta qytetarë kanë votuar Partinë Demokratike, të jesh i sigurtë ti se edhe qytetarët e Tiranës me këto veprime bastarde që ke bërë gjatë kësaj kohe ti o ditziu i "mjaftit", shpejt ke për të parë veten atje ku pjerdhin gomerët, se edhe qytetarët e Tiranës kanë për të thënë "mjaft" dhe do të dërgojnë përpara ligjit dhe drejtësisë që të përgjigjesh për të gjitha prapësitë dhe hajdutëritë kundër popullit, të përgjigjesh për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit. I sigurtë të jesh ti, se ashtu si Koço Kokëdhimën, poturet e Edi Ramës nuk do munden që ta mbrojnë dhe ai humbi si "shurrë e pulës". Kështu si e ke zënë me delirin tënd të marrëzisë, shumë shpejt do të lëpësh prapa hekurave si qen i rrahur. Dhe kjo po ndodh.

Mali i Zi nënshkuan sot protokollin e anëtarësimit në NATO

Mali i Zi do të nënshkruajë sot protokollin e anëtarësimit në NATO që do t'i mundësojë pjesëmarrjen në të gjitha takimet e Aleancës, si vend vëzhgues ose i ftuar. Sekretari i përgjithshëm i Aleancës Veri-Atlantike, Jens Stoltenberg, ka thënë se pasi ta kenë ratifikuar protokollin të gjitha vendet anëtare të NATO-s, Mali i Zi do të bëhet vendi i 29-të anëtar i saj. "Është një ditë historike për aleancën, për Malin e Zi dhe për qëndrueshmërinë në Ballkanin Perëndimor, sepse zgjerimi i NATO-s me Malin e Zi konfirmon se dyert e NATO-s janë të hapura dhe është një hap i ri në një politikë shumë të suksesshme të zgjerimit edhe të NATO-s, edhe të Bashkimit

Evropian. Zgjerimi i NATO-s, për shumë vite, i ka kontribuar stabilitetit, paqes dhe sigurisë në Evropë dhe tani Mali i Zi do të jetë pjesë e saj", ka thënë Stoltenberg. Ai i ka bërë këto komente në prag të një takimi të ministrave të Jashtëm të NATO-s, i cili zhvillohet të enjten dhe të premten në Bruksel. Podgorica ka marrë ftesën për anëtarësim në NATO në dhjetor të vitit të kaluar, 16 vjet pasi aleanca ka bombarduar Malin e Zi gjatë luftës në Kosovë, kur ai ende ka qenë pjesë e Jugosllavisë. NATO, për herë të fundit, është zgjeruar në vitin 2009 me Shqipërinë dhe Kroacinë. Mali i Zi ka një ushtri të vogël me rreth 2000 anëtarë aktivë.

Administrata amerikane autorizohet që ta përgatis Kosovën për Partneritetin për Paqe të NATO-s

Kongresi Amerikan i ka bërë thirrje administratës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ta përgatis Kosovën për programin e NATO-s "Partneriteti për Paqe". SHBA ka dërguar këto sinjale në kohën kur vendi ende nuk po arrin që ta transformojë FSK-në në Forca të Armatosura të Republikës së Kosovës për shkak të mospajtimeve brenda koalicionit aktual respektivisht kundërshtimeve të Listës Srpska. Kongresi amerikan ka autorizuar Administratën Amerikane që të punojë me Republikën e Kosovës për t'i ndihmuar që të hyjë në Partneritetin për Paqe. Kongresi nëpërmjet

"Defence Authorisation Act" ka votuar mbrëmë unanimisht amendamentin me të cilin i kërkohet administratës amerikane që të "punojë me Republikën e Kosovës që ta përgatis vendin për të hyrë në Partneritetin për Paqe". Pjesëmarrja në Partneritetin për Paqe është kërkuar nga autoritete kosovare pavarësisht se Kosova ende nuk po arrin të transformojë FSK-në në Forca të Armatosura për shkak të refuzimit të Partisë Lista Srpska e cila aktualisht është duke refuzuar që të japë mbështetjen e saj në Parlament për këtë çështje. Kosova aktualisht është anëtare vëzhguese e

Asamblesë Parlamentare të NATO-s ndërkohë që orientim strategjik i vendit është edhe anëtarësimi në NATO. Qëllimet e Partneritetit për Paqe janë inkurajimi i transparencës në planifikim dhe në buxhetet kombëtare për mbrojtjen, promovimi i kontrollit demokratik mbi forcat e armatosura, zhvillimi mbi kapacitetin për veprime të përbashkëta, siç janë operacionet paqeruajtëse ose në raste katastrofash. Partneriteti për Paqe konsiderohet hap i rëndësishëm drejt anëtarësimit në NATO. Kosova në këtë aspekt ballafaqohet edhe me një problem tjetër, për faktin që nuk njihet nga 4 vende të NATO-s.

Thirrjet raciste të Erion Veliajt

Or ti çuni nga Paraspuari, kur u bërë "qytetar i madh"?

Nga Dane Pelo

Nuk është ndonjë sekret i madh apo gjë e paditur të themi se regjimi komunist e ndërtoi pushtetin e vet mbi urrejtjen klasore dhe dasinë veri-jug. Filozofia e të dyjave ishte porosi e qartë dhe e prerë e Dushan Mugoshës dhe Miladin Popoviçit kur këta themeluan dhe drejtuan Partinë Komuniste të Shqipërisë. Banda e kuqe që drejtuan këta jugosllavë pasi u ngjiz në jug të vendit, shkaktoi luftën civile këtu, vrau preu e masakroi familjet me të mira e më patriotë të jugut dhe më pas, po me këtë egërsi iu sul

veriu të vendit. Kjo bandë u vendos në Tiranë. Përzuri gjithë armiqtë që i mendonte të tillë, vodhi e vrau çfarë kishte kundërshtarë dhe po kështu filloi të rrisë klasën e vet me baza nepotike të stërgjata. Në filozofinë e bijve të kësaj klase, u kultivua vazhdimisht urrejtja për veriun e vendit. Banorët e veriut ishin "malokë", "alpinë", "shpellorë", etj, ndërsa këta që kishin ardhur nga skutat më të largëta të Shqipërisë ishin bërë "tiranaz" tashmë.

Erion Veliaj bir i një familje shërbëtorësh ndaj regjimit komunist, nuk mund të jetë ndryshe. Ai do të nxjerrë



në treg ato gjëra me të cilat është rritur. Veliaj nuk është rritur në familje lordësh apo fisnikësh që

hajn mo, mund të ketë një nënçmim për të tjerët. Është bir oficerësh. Nga zgafellet prej nga ka origjinën kanë

një shprehje të bukur: "o me dele o me kapele". Pra ose çoban ose oficer. Nga babai Erion Veliaj është nga Velça e Vlorës. Të dy fshatrat janë shquar për blegtorë të mëdhenj. Nëna dhe babai i Veliajt u sollën në Tiranë prej regjimit, me sa duket për të mbajtur lart luftën ndaj "malokëve" apo armikut të klasës. Erion Veliaj ndoshta ka harruar por në vitin 1991 kur shokët e tij të klasës dëmtonin fotografinë e shokut Ramit, ai shkonte dhe e pastronte ato.

Në intervistën e fundit që dha, Veliaj shprehu më mirë se çdo gjë dy gjëra për të cilat komunistët janë shquar gjithnjë: mburraveçërinë dhe vulgaritetin. Sado të mundohet ta fshehi, sado që sforcohet, nuk rri dot pa dalë në origjinë. Mburret sikur është ndonjë punëtor i madh në një kohë që punën e parë në administratë e pati si ministër. Ky "punëtor i madh" që nuk jetonte dot pa ndihma të gatshme që në popull i thonë "qyl", tanimë na u bë menaxher i madh. Në lidhje me vulgaritetin duhet thënë vetëm një fjalë: do të duheshin 10 breza të bëhesh qytetar.

Zbërthehet Erion Veliaj, në sulm ndaj Presidentit, institucioneve shtetërore dhe qytetarëve

Bashkia Kamëz: Veliaj dordolec me gjuhë bastarde, hoqi nga ndihma ekonomike 6 mijë familje, lumi i Tiranës një geto

Bashkia e Kamzës ka reaguar pas gjuhës jo etike të përdorur nga Erion Veliaj një ditë më parë në një emision televiziv, i cili ofendoi banorët e Kamzës dhe të Paskuqanit. Në një deklaratë për mediat, Bashkia e Kamzës i ka kërkuar Veliajt që të kontrollojë mënyrën e të folurit dhe të mos ofendojë banorët e Kamzës dhe të Paskuqanit. "Erion Veliaj vijon gjuhën e tij raciste dhe diskriminuese ndaj qytetarëve dhe Bashkisë së Kamzës. Kjo gjuhë bastarde

që përdor kryetari i Bashkisë së Tiranës ka në nëntekst largimin e vëmendjes nga punët e mëdha që ka qyteti i tij. Ky dordolec duhet të mbajë gojën e të mos i fyejë banorët e Kamzës dhe Paskuqanit, këta banorë punëtorë dhe të zgjuar, pasi me djersën e tyre këto 25 vite ndërtauan një jetë nga fillimi duke e nisur nga zero, duke punuar e fituar paranë me djersën e ballit dhe jo si ti dhe Mjafit-istët dhe G99-shat që me zero ditë pune na u bënë ministra,

kryetar bashkie, uzurpuan administratën, u bënë milionerë dhe menjëherë iu sulmën të ardhurave duke u hequr edhe ndihmën ekonomike, vetëm në Kamëz 6 mijë familjeve, pra duke u hequr bukën e gojës. Këtë gjë nuk ta falin banorët e Kamzës", thuhet në reagimin e Bashkisë Kamëz. Më tej, thuhet se "Veliaj nuk po bën gjë tjetër, por po ecën nën gjurmët e padronit të tij Edi Rama dhe po nxitin një konflikt që asnjë në këto

25 vite nuk e ka bërë, pra që të dy janë antiveriorë. E kanë shprehur këtë gjuhë urrejtjeje dhe më parë siç Rama shefi i Veliajt, duke i ironizuar në një takim elektoral veriorët, kur tha që na vijmë nga Alpet; i quajti shpellorë, Veliaj vandalë se nuk na ditkan ku është liqeni etj. Erioni le të merret me investimet në territorin e Bashkisë së Tiranës në kufi me Kamzën siç është lumi i Tiranës, që e ka kthyer në një geto të vërtetë. E vetmja gjë që ka

në vizionin e tij është rritja e taksave, që ky kryebashkiak i Tiranës përdor çdo ditë ndaj qytetarëve dhe bizneseve të Tiranës. Ndërsa kërkon të merret edhe me administrimin e Kamzës, pyesim se çfarë bëre mirë deri tani ti Erion, që të ta lëmë edhe Kamzën që ta bësh "dritë"? Nuk duam të përmendim mynxyrën, duke lënë në harresë të gjitha njësitë administrative që janë pjesë e kryeqytetit, si rezultat i reformës administrative-territoriale.

Je i vetmi pushtetar që ngrihesh dhe u bën presione institucioneve gjyqësore dhe ndërsa ne mendojmë që ti duhet t'i drejtohesh drejtësisë për shkelje të rënda të Kushtetutës, vjen e bën dordolecin duke futur hundët në punët e njësive të tjera administrative. Edhe si ministër Erion vetëm për një gjë u bëre mediatik, për dasmën mbi kala! Qytetarët e Kamzës kanë ditur dhe dinë të orientohen drejt në zgjedhjet e tyre", përfundon deklarata e bashkisë Kamëz.

Këshilltarët e djathtë: Erion Veliaj, një kamikaz i Edi Ramës, e papranueshme gjuha denigruese ndaj Presidentit dhe institucioneve shtetërore

Kryetari i këshilltarëve të djathtë në Bashkinë e Tiranës, Leonard Olli ka dënuar gjuhën e përdorur të kryebashkiakut Erion Veliaj ndaj Presidentit të Republikës Bujar Nishani. Në një deklaratë për mediat, Olli e ka akuzuar Veliaj se po kërcënon dhe po i bën presion gjyqtarëve për të mbuluar aferat e tij korruptive. "Kryetari i Bashkisë së Tiranës refuzon të plotësojë një detyrim të qartë ligjor sikundër është Neni 51, pika 3 e Ligjit për Qeverisjen Vendore, informimin e këshilltarëve në çdo kohë dhe për gjithçka. Të ndodhur përpara kësaj mungese totale transparence, si një nga pikat më të rëndësishme të funksionit të këshilltarit, që të informohet dhe të kontrollojë punën e Bashkisë, jemi detyruar ti drejtohem gjykatës. Ne kemi paditur z.Veliaj, sepse ligji përcakton që është kryetari i Bashkisë i cili informon anëtarët e Këshillit Bashkiak.

Kemi kërkuar informacion për mbarëvajtjen e Bashkisë, shumë të thjeshta, janë kërkesa për pushimet nga puna dhe marrjen e personave të ndryshëm, informacion në lidhje me ristrukturimin dhe arsyet përse e ka bërë Bashkia këtë. Tenderat që ka zhvilluar kjo Bashki. Mos transparenca fsheh afëra korruptive, sepse nuk ka asnjë arsye tjetër për të mos parë këto ditë z.Veliaj në një shfaqje të paprecedentë, si një jakobin i Shekullit të XXI, që të sulmojë, rrethojë dhe të tentojë të intimidojë institucionet e pavarura të drejtësisë", tha Olli. Më tej ai shtoi se jo më larg se dje nga një studio televizive, me një zhargon që nuk i takon kryeqytetasit të Tiranës, ka sulmuar sërish institucionin e Presidentit të Republikës. "Për ne, është e qartë ai tashmë është shndërruar në një kamikaz të Edi Ramës. Tentativa e tij për intimidimin dhe krijimin e

këtij rasti të paprecedentë ka një prapavijë, është një prapavijë politike. Kërcënim i hapur, që bëri se ai do të përndjekë çdo gjyqtar, apo çdo punonjës të institucioneve të tjera shtetërore, të cilët dalin kundër dëshirave apo tekave dhe trilleve të tij personale, është shenja më e mirë që kemi të bëjmë me një element antishtet, anti ligj, anti sistem. Ai po përpiket të intimidojë sistemin e drejtësisë për të mbuluar skandalet që pasojnë njëri-tjetrit dhe aferat e tij korruptive. E ka të kotë. Do të përgjigjet deri më një përpara drejtësisë për të gjitha shkeljet. Si për tenderat, ashtu edhe për veprat e tjera të shpërdorimit të detyrës duke filluar që nga Liqeni, koncensionet dhe të gjitha të tjerat", u shpreh Olli.

Myqerem Tafaj: Veliaj të kërkoj ndjesë publike për gjuhën denigruese të përdorur ndaj qytetarëve të Kamzës dhe

Paskuqanit/ Deputeti demokrat Myqerem Tafaj ka reaguar për fjalorin denigrues të Erion Veliajt. Tafaj thitë se Veliaj duhet t'u kërkojë ndjesë banorëve të Kamzës dhe Paskuqanit për gjuhën denigruese, ndërsa thekson se kjo është një urrejtje patologjike e rilindsave për Shqipërinë Veriore dhe Verilindore. Tafaj gjithashtu thekson se Qytetarët e Tiranës nuk kanë zgjedhur një kryebashkiak që fyen qytetarët, fyen Presidentin e Republikës dhe nuk respekton Kushtetutën tonë. "Fjalori i papranueshëm dhe tejet diskriminues i Veliajt ndaj qytetarëve fisnik të Kamzës dhe Paskuqanit, të ardhur nga Veriu dhe Verilindja, tregon urrejtjen patologjike të tij dhe rilindasve socialistë ndaj Shqipërisë Veriore dhe Verilindore. Kjo është gjuhë dhe qëndrim i trashëguar nga ish Blloku komunist. Një gjuhë e tillë denigruese, diskriminuese dhe përçarëse bie nënsh me Kushtetutën tonë, ligjet tona

dhe të gjitha konventat ndërkombëtare. Në çdo vend demokratik, kur një politikan i lartë përdor shprehje fyese ndaj qytetarëve, jo vetëm që kërkon ndjesë publike, por dorë hiqet nga politika. Po ku pyet Veliaj për standarde demokratike? Ku pyet Veliaj për Kushtetutën e Shqipërisë? Ku pyet Veliaj për Kryetarin e Shtetit? Qytetarët e Tiranës nuk kanë zgjedhur një kryebashkiak që fyen qytetarët, fyen Presidentin e Republikës dhe nuk respekton Kushtetutën tonë", deklaroi Tafaj.

Ndërtimi tek Diga/ Gjykata rrëzon kërkesën e Veliajt, ai nis kërcënimet ndaj qytetarëve: Mos i bjerni telefonit të kërkoni çudira, qyteti nuk iu shërben/ Erion Veliaj kërcënoi qytetarët, ndërsa deklaroi se nuk do ta zbatoj vendimin e Gjykatës. Duke thënë se ishte një ekspozim i pacipë i Gjykatës dhe se do t'i shkojë deri në fund duke bërë transparencën, në shpërthimin e tij kërcënues

ai nxori në shesh edhe disa sekrete të marrëdhënies mes tij me qytetarët dhe gjyqtarëve dhe i kërcënoi ata hapur. "Mos i bjerni më telefonit të kërkoni çudira. Kur merrni vendime kundër qytetit, qyteti nuk ju shërben", tha Veliaj. Por ky kërcënim i Veliajt përbën një rast skandaloz. Bashkia e Tiranës ka detyrimin ligjor t'u shërbejë të gjithë qytetarëve të saj që paguajnë taksat, pavarësisht funksioneve që kryejnë, bindjeve politike apo vendimeve që ata marrin në punën e tyre. Kryebashkiaku theksoi gjithashtu me siguri të madhe se kullat poshtë digës së liqenit nuk do të ndërtohen dhe këtë nuk do ta lejojë. Prej disa ditësh, Veliaj flet me gjuhë të ashpër ndaj qytetarëve dhe Presidentit të Republikës e gjyqtarëve. Por, sot kaloi çdo cak me kërcënimin e hapur se kryetari i Bashkisë ligjin për t'u shërbyer qytetarëve do ta respektojë sipas interesave dhe preferencave të tij.

Garda e Ruisisë si trupë policore e vetë Putinit

Presidenti Putin ka nisur një reformë të madhe policore. Garda e re do të jetë në varësi personale të presidentit. Vëzhguesit spekulojnë nëse ajo do të përdoret kundër terrorizmit apo kundër opozitës?

Parlamenti rus voton të mërkurën në leximin e parë për krijimin e një force të re policore. Me këtë çohet një hap më tej reforma e shpallur papritur në fillim të prillit nga Putinit.

Së pari u bë fjalë për krijimin e Gardës Kombëtare, por disa e konsideruan këtë term si të zgjedhur keq. Për disa, ai tingëllonte «shumë perëndimor». Të tjerë kritikuan se ai të kujton Gardën Kombëtare të Ukrainës, e cila në Rusi quhet «Skuadrat e ndëshkimit», sepse ajo është themeluar rreth dy vjet më parë për të marrë masa kundër separatistëve prorusë në lindje të vendit. Sipas projekt-ligjit të botuar më vonë emri i shkurtër ishte «Rosguardija», që përkthehet si «Garda ruse» ose «Garda e Ruisisë».

Organizata e re do të ngrihet kryesisht mbi bazën e të ashtuquajturave forca të brendshme

të Ministrisë së Brendshme. Fjala është për njësi të policisë të ngjashme me ato të ushtrisë, të cilat veprojnë në vend që nga koha sovjetike. Përveç kësaj në strukturën e re do të përfshihen edhe njësitë speciale të policisë Omon dhe të shërbimit të rojeve policore. Ekspertët rusë vlerësojnë se numri i përgjithshëm i Gardës së re të Ruisisë do të jetë 30.000 - 400.000 vetë. Shifrat zyrtare nuk ka. Dallimi qendror me më përpara: forca e re e policisë do të jetë drejtpërdrejt nën komandën e Presidentit. Në krye të Gardës së Ruisisë në rangun e një gjenerali të ushtrisë Putini emëroi një të besuar të tij prej shumë kohësh, Viktor Zolotov. 62-vjeçari ishte zëvendësministër i Brendshëm dhe shefi i trupave të brendshme. Gazeta e Moskës «Novaya Gazeta» e përshkruante një herë Zolotov si «njeriun më të afërt të presidentit rus.»

Ashtu si Putini edhe Zolotovi ka shërbyer në KGB. Në vitet 90-të ai ishte përgjegjës për mbrojtjen personale të kryetarit të komunës së Shën Petersburgut, Anatoli Sobçak, dhe zëvendësit të tij Putinit. Kur Putini u bë në vitin 1999 kryeministër, Zolotovi ishte truproja e tij kryesore. Pas zgjedhjes së Putinit si president në vitin 2000, Zolotovi u gradua si kreu i Shërbimit të Sigurimit Presidential, ku qëndroi për më shumë se dhjetë vjet. Margarete Klein nga fondacioni i Berlinit «Stiftung Wissenschaft und Politik» (SWP) e sheh emërimin Solotovit si një tregues që «nën presidentin po krijohet i një organizatë, e cila lidhet vërtetë me personin e tij».

Hamendje për qëllimet e trupës së re/Në Rusi po hamendësohet se cili mund të jetë qëllimi i vërtetë i krijimit të trupës

së re. Putini e arsyetoi krijimin e Gardës së Ruisisë me sfidat e reja të vendit. Sipas projekt-ligjit ndër detyrat e trupës janë mbrojtja kundër terrorizmit apo mbrojtja e objekteve strategjike, por gjithashtu përmendet edhe «sigurimi i një regjimi të gjendjes së jashtëzakonshme». Kjo do të thotë se Garda e Ruisisë mund të përdoret edhe për shpërndarjen e demonstratave apo të protestave. Ajo do të ketë të drejtë të qëllojë pa paralajmërim, të bastisë banesa ose mund të paralizojë sistemin e telefonave celularë. Disa ekspertë mendojnë se Garda e Ruisisë do të përdoren sidomos në rast protestash pas zgjedhjeve parlamentare të vjeshtës 2016 dhe gjatë zgjedhjeve parlamentare në vitin 2018. Shpjegimi i dytë mjaft i përhapur është se struktura e re ka si detyrë ta mbrojë Putinin prej ndonjë grushti të mundshëm shteti

nga radhët e veta. Në lidhje me këtë mundësi ka kohë që spekulohet, edhe pse prova konkrete nuk ka. **Kërcënimi prej të kthyerve nga ISIS-i/»Novaya Gazeta»** përmendi edhe një shpjegim të tretë të mundshëm. Garda e re e Ruisisë do të ketë ndër të tjera si detyrë dobësimin e kreut të fuqishëm çeçen Ramzan Kadyrov. Kadyrovi ka ndërtuar në republikën ruse në Kaukazin Verior një trupë të fuqishme policore e cila i takon vetëm atij. Kjo trupë tani do të përfshihet në Gardën e Ruisisë. Margarete Klein nga fondacioni SWP tërheq po ashtu vëmendjen se edhe arsyeja zyrtare, lufta kundër terrorizmit, luan një rol. «Rusia është një nga vendet që preket më fort prej sulmeve terroriste në mbarë botën,» tha ekspertja për DW-në. Sidomos të kthyerit nga milicia terroriste «Shteti Islamik» (IS) janë një kërcënim real.

A na duhet një konsensus nacional?

Nga Skënder Mulliqi

Kosova deri më tash i kaloi disa palë zgjedhje nacionale dhe zgjedhje lokale. Dhe shtrohet pyetja logjike “A kishte populli liderë të cilët i meritojnë?”. Shumë herë deri më tash e kemi munduar kokën me këtë pyetje hipotetike, duke ia parashtruar vetit dilemat e mëdha rreth kësaj teme. Shumëkush prej nesh kemi thënë se si erdhën dhe nga na erdhën këta autsajder në krye të shtetit të ri të Kosovës. Menjëherë pas luftës secili nga ne nuk e kemi menduar shumë këtë gjë. Pas 17 vitesh duke rkapituluar të gjithë atë se çka kemi arritur dhe përjetuar, mund të bëjmë analiza pak më substanciale, se a i zgjodhëm apo na u imponuan këta liderë partiakë dhe shtetërorë. Fillimisht duket se më shumë u përballëm me liderë të cilët u imponuan, sesa populli kishte kohë me menduar për zgjedhjen e njerëzve të cilët do ta drejtojnë shtetin e tyre. Këta që erdhën në pozitë e larta shoqërore, edhe nëse kanë trashëguar merita nga lufta, në kushte të paqes u treguan diletantë të vërtetë në politikëbërje dhe shtetndërtim. Dhe, shumëkush nga qytetarët e Kosovës, sot do të dëshironin të ishte qytetar i ndonjë vendi tjetër shumë më të pasur dhe shumë herë më demokratik. Ky “autoshovinizëm” ka krijuar pakënaqësi të mëdha, i ka rritur frustrimet dhe ka demoralizuar njeriun tonë nga padrejtësitë që po i bëhen në vazhdimësi dhe ende po vazhdojnë. Është instaluar logjika se na janë mbyllur të gjithë rrugët e progresit dhe jetës më të mirë. Po ia mësyjmë dyerve të Evropës si lypës për një kore bukë, si mall shumë i lirë për t'u shitur. Një populli të tërë po ua grabisin të gjitha të mirat materiale, dhe nuk po ndihen fare të turpëruar. Ky establishment politik po shkelin mbi të gjallët dhe të vdekurit pa mëshirë. Po e ndrydhin këtë popull si të ishin do bubreca e jo genie njerëzore. Nga njerëzit normalë kanë krijuar njerëz

depresivë. Ua kanë humbur motivin dhe ëndrrat për jetë. Populli në vend të fitores ka mbetur humbësi më i madh. Kasta politike edhe pse humbës në politikëbërje, janë bërë fituesit e të mirave materiale. Këta liderë partiakë dhe shtetërorë ringjallën ekonomin e tyre familjare, duke rrënuar në anën tjetër ekonominë, industrinë e rëndë, duke vjedhur dhe plaçkitur nga procesi i privatizimit dhe shumë grabitje dhe uzurpime të tjera. Kampanjat partiake i bënë me para të popullit duke e mashtruar popullin pas secilës palë të zgjedhjeve. E keqpërdorën dhe po e shkelin gjakun e shumë martirëve dhe heronjve të kombit që i kishim historikisht. Kemi menduar se progresi është linear, që secilin vit do të bëhet më mirë, se do të arrijmë të punojmë dhe fitojmë më shumë duke vazhduar me tempo të mirë përpara. Edhe fëmijët e kanë marrë tashmë vesh se cilët janë këto figura politike, të cilët po ua zënë vendin njerëzve të ditur dhe të përgatitur profesionalisht. Me rrena dhe kopalla nuk ndërtohet shteti dhe as mirëqenia. Është mëse i nevojshëm më duket mua një konsensus apo marrëveshje nacionale, për kapërcimin e gjendjes jo të mirë politike dhe ekonomike në të cilën jemi katandisur. Kemi shumë mostra të mira nga shtetet e zhvilluara të Evropës se si bëhen ndershëm fushatat dhe se si ata të cilët vijjnë në pushtet sillen konform kërkesave të qytetarëve nga të cilët edhe e kanë marrë besimin. Më e freskët për në është fushata për zgjedhje nacionale në Amerikë. Gati përpikmërisht zëri i qytetarëve të cilët i kanë përkratur liderët e tyre do të vijë në shprehje. Kësaj i thonë demokraci, kësaj i thonë dashuri ndaj kombit dhe atdheut. Ne, jemi në Evropë por edhe bota na është afruar shumë përmes mjeteve moderne elektronike, të cilat po na mundësojnë të shohim se si bëhet jeta politike dhe jeta përgjithësisht në botën e civilizuar. Dhe, kur njeriu ynë bën një krahasim të tillë e ka shumë vështirë të mësohet më jetën e keqe të cilën po e bëjnë në Kosovë.

Fëmija i revolucionit kulturor

Pesëdhjetë vjet më parë këtë muaj, Mao Tseduni nisi Revolucionin Kulturor të Kinës – një dekadë me kaos, persekutime dhe dhunë, të kryera në emër të ideologjisë dhe në interes të pushtetit. Në vend që të reflektojë mbi trashëgiminë e dhimbshme të kësaj periudhe, presidenti Xi Jinping po përdor metodat e saj në përpjekje për të siguruar pushtet absolut.

Nga Ma Jian (Project Syndicate)

Pesëdhjetë vjet më parë këtë muaj, Mao Zedong nisi Revolucionin Kulturor të Kinës – një dekadë kaosi, persekutimi dhe dhunë kryer në emër të ideologjisë dhe në interes të zgjerimit të pushtetit personal të Maos. Megjithatë, në vend që të reflektojë në trashëgiminë shkatërrimtare të kësaj periudhe, qeveria e Kinës po shmang çdo diskutim mbi të dhe qytetarët e Kinës, të kënaqur mirëqenia që erdhi nga tri dekada reformash të orientuara nga tregu, deri tani janë mjaftuar me harresë. Por në një kohë kur presidenti Xi Jinping po kryen spastrime të pamëshirshme e po krijojnë kultin e tij të personalitetit, groposja e të shkuarës nuk është pa kosto. Në gusht 1966, Mao publikoi Bombardoni Qendror – një dokument që synonte të mundësonte spastrimin e Partisë Komuniste Kineze nga “kriptomarkalistët”: presidenti i asaj kohe Liu Shaoqi. Në dokument, Mao i bëri thirrje rinisë së Kinës “ta rrëzonin perandorin nga kali” dhe të fillonin një rebelim nga poshtë. Të rinjtë u përgjigjën me zell. “Rojet e Kuqe” grupime paraushtarake studentore, u shfaqën me shpejtësi në të gjithë vendin për të çuar përpara dëshirën e Maos. Brenda 100 ditëve, Mao ia doli të spastronte pjesën më të madhe të udhëheqësive së partisë, përfshirë Liun dhe Ten Siao-pinin. Por nuk qenë vetëm kundërshtarët politikë të Maos të cilët u vunë nën sulm. Gjatë muajve gusht dhe shtator, Rojet e Kuqe vranë

më shumë se 1,700 njerëz, ose duke i rrahur deri në vdekje ose duke i detyruar të kryejnë vetëvrasje, ata përzunë mbi 100 mijë banorë nga Pekini dhe dogjën shtëpitë e plaçkat e tyre. Mësuesit qenë veçanërisht të sulmuar. Sa herë që Rojet e Kuqe shfaqeshin te shkollat fillore, shkollat e mesme apo universitetet, mësuesit dhe drejtorët keqtrajtoheshin. Nuk kaloi shumë kohë para se Mao të kthehej kundër Rojeve të Kuqe, kur vendosi se anëtarët e tyre qenë “shërbëtorë” të kriptomarkalistëve. Pasi vendosi ligjin ushtarak në të gjithë Kinën, Mao i mbushi Rojet e Kuqe me rebelë të ri proletarë, shpesh duke shpërngulur anëtarët fillestar të grupimeve nëpër fshatra të largëta për “ri-edukim”. Për Xi, ngjarjet e Revolucionit Kulturor janë gjëra që ai i di nga eksperiencia e vet. Babai i tij, Xi Zhongxun, një zyrtar i lartë i Partisë Komuniste, u rrëzua nga pushteti, u burgos dhe në fund u dërgua në një fabrikë për të prodhuar traktorë, ndërsa familja e tij u shpërndo nëpër fshatra. Megjithatë në vend që të distancohet nga ideologjia dhe organizata që shkatërroi familjen dhe vendin e tij, Xi po përdor elementët dhe mjetet kyçe të Revolucionit Kulturor për hesap të vet. Xi duket se ka ruajtur brenda vetes aspektin luftënxitës të Revolucionit Kulturor të rinisë së vet. Pushteti është parimi i tij udhëheqës dhe duket se ai është i gatshëm të bëjë gjithçka për ta mbajtur atë. Në këtë përpjekje, ai ka një avantazh kyç: Trashëgiminë e Maos. Për shumë dekada, Mao promovoi një formë të

luftës së klasave në të cilin qytetarët informonin mbi njëri-tjetrin, madje edhe miqtë e tyre më të ngushtë, fqinjët dhe familjarët e vet. Për shkak të pasigurisë që krijonte kjo situatë, çdokush – madje edhe joanëtarët – bëhej shërbëtor i Partisë Komuniste. Në këtë mjedis frike, shteti me qetësi dhe efikasitet shkatërroi identitetin personal. Barbaria kërkonte vendosjen e pushtetit absolut mbi popullsinë dhe ky është një leksion i Revolucionit Kulturor ndaj të cilit Xi duket indiferent. Ai është i shqetësuar vetëm për pjesën e “pushtetit absolut”. Dhe në përpjekjet për ta kapur këtë pushtet, të mbijetuarit e Revolucionit Kulturor – njerëzit që e dinë se çfarë do të thotë të frikësohesh për të zgjedhur politikën mbi personalen – janë bërë kapitali më i çmuar politik i Xi. Xi e di se ai mund t’ia dalë vetëm duke përforcuar autoritetin e Partisë dhe pozicionin e tij si udhëheqës. Kështu ai ka prezantuar një narativë në të cilën supozon se ka një kërcënim të madh për Kinën që vjen nga brenda – një kërcënim i krijuar nga udhëheqës tradhtarë të korruptuar – dhe ka deklaruar se besnikëria ndaj Partisë është më rëndësi vendimtare. Ka vetëm dy lloje njerëzish: ata që mbështesin Partinë dhe ata që nuk e mbështesin. Njësoj si Mao më 1966, Xi beson se pushteti i tij varet nga bërja e të gjithë kinezëve – zyrtarë të qeverisë e qytetarë të zakonshëm – besnikë të bindur përmes çdo mjeti të mundshëm. Pushteti bazohet në represionin e kundërshtarëve, të tillë si fituesi i Çmimit Nobel për Paqen Liu Xiaobo dhe dhjetëra-mijëra shkrimtarëve

e studiuesve të tjerë të burgosur. Por Xi nuk mbështetet vetëm te frika për të cimentuar sundimin e tij. Ai po përpjeket gjithashtu të fitojë mbështetje popullore me një ideologji të re unifikuese, të mbështetur në të ashtuquajturën Ëndrra e Kinës, një seri vlerash socialiste dhe qëllimesh që supozohet se do të sjellin “përtëritjen e madhe të kombit kinez.” Kjo është shoqëruar nga një formë galvanizuese nacionalizmi që e paraqet botën, në veçanti Shtetet e Bashkuara, si forca që përpiqen ta mbajnë Kinën të prapambetur duke supozuar se vendi që i takon Kinës është në majë të rendit botëror. Dhe ai ka ushqyer një kult personaliteti të atij lloji që nuk është parë kurrë që nga koha e Maos. Pesëdhjetë vjet pas Revolucionit Kulturor, krimet dhe mëkatet e tij mbeten të padënuara. Përkundrazi, ai po përdoret për të justifikuar më shumë shtypje politike dhe shoqërore në Kinë. Por, pavarësisht se çfarë bën Xi, përpjekjet e tij për të siguruar autoritet të stilit të Maos ka gjasa do të përfundojnë shumë ndryshe për të, me sundimin e tij ekonomik jokompetent dhe spastrimet politike e represionin që gradualisht po krijojnë trupa sekrete që e kundërshtojnë atë. Ndërsa dëshimet ekonomike po shpërthejnë gjithnjë e më shpesh në rebelime politike, Rojet e Kuqe mund të rishfaqen sërish në rolin e tyre qendror në Revolucionin Kulturor, mbështetur nga një gjeneratë tjetër të rinjsh të nuk kanë mësuar nga historia. Por këtë herë, “perandori” që do të rrëzohet nga kali do të jetë pikërisht Xi.

Në shkollat fillore të Maqedonisë, as gjysma e nxënësve nuk janë maqedonas!

I del kallaji propagandës me popullsinë maqedonase, si popullsi shumicë në FYROM. Sipas statistikave të ministrisë së Arsimit, as gjysma e nxënësve të sistemit parauniversitar nuk janë maqedonas, ndërkohë që numri i shqiptarëve është afro 33 përqind, 10 përqind më shumë se shifra formale, sipas regjistrimit të manipuluar të popullsisë

Ne shkollat fillore të Maqedonisë, as gjysma e nxënësve nuk janë maqedonas! Numrat e nxënësve të shkollave fillore zbulojnë se në Maqedoni janë të manipuluar përqindjet e popullsisë, konkretisht tregojnë se shqiptarët janë 13 përqind më shumë se sa llogaritet numri i tyre, kurse i maqedonasve - 16 përqind më pak. Në kategorinë e nxënësve maqedonas, ku hyjnë edhe romët, boshnjakët, vllahët, kroatët e të tjerët, janë 104.204 nxënës nga 190.541 gjithsej. Pra, jo më shumë se 54.7 përqind edhe atë bashkë me të tjerët (të cilët përbëjnë 5.3 përqind të popullatës). Ndërkaq, në kategorinë e nxënësve shqiptarët janë 62.188 nxënës, apo 32.6 përqind e numrit të përgjithshëm. Të konsideruara prej kohësh si pasqyra më reale e mozaikut etnik të shtetit, shkollat fillore pa ndonjë mundim të madh janë në gjendje të zbulojnë tablonë më reale të përqindjeve të ndryshme etnike në Maqedoni. Siguria më e madhe për këtë qëndron në prirjen shumë të natyrshme të nxënësve që të mësojnë në gjuhën e tyre amtare, sidomos kur është në pyetje shkollimi në nivelin e arsimit fillor - edhe pse sikurse tregojnë numrat e nxënësve nëpër paralele, ka përzjashtime nga ky përkufizim. Të paktën në vitin shkollor 2013/2014 janë mbi 1200 shqiptarë dhe mbi 2800 turq, të cilët mësojnë në paralelet maqedonase, ashtu sikurse ka 45

maqedonas të cilët mësojnë në gjuhën serbe, apo 184 shqiptarë që mësojnë në gjuhën turke. Sidoqoftë, këto numra edhe pse jo pa ndikim në përqindjet e nxënësve sipas etnitetit, janë të papërfillshme nëse krahasojmë dallimet që ekzistojnë mes përqindjeve etnike të nxënësve nëpër shkolla dhe përqindjeve që zyrtarisht përdoren për të treguar konfigurimin demografik të Maqedonisë, respektivisht popullsisë që jeton këtu. **Kamufliimi**/Ndryshimi më i thellë mes përqindjeve zyrtare mbi numri e popullsisë dhe përqindjen e nxënësve sipas etnisë rezultojnë te maqedonasit dhe shqiptarët, mirëpo në konotacione diametralisht të kundërt. Maqedonasit, për të cilët me Regjistrimin e fundit të popullsisë (të vitit 2002) thuhet se janë 65.2 përqind, në arsimin fillor nuk janë hiq më tepër se 54.7 përqind, respektivisht 104.254 nxënës nga 190.541 nxënës. Ndërkaq shqiptarët, të cilët Regjistrimi i të njëjtit vit i nxjerr 25.2 përqind, sipas numrit të nxënësve nëpër shkolla fillore - janë 32.6 përqind, konkretisht 62.188 nxënës. Pra ka një predispozitë të hapur për të manipuluar përqindjet e maqedonasve dhe shqiptarëve në shtet edhe atë me 11, respektivisht 16 përqind më tepër për maqedonasit dhe 13 përqind më pak për shqiptarët. Numri i nxënësve të shkollave fillore pa asnjë dilemë mund të shërbejnë

si njëra prej referencave më të sigurta për t'ju dhënë përgjigje shumë pyetjeve se sa maqedonas, shqiptarë, turq, boshnjakë, serbë, e të tjerë jetojnë në Maqedoni. Megjithëse i kamuflluar në ndarjen e paraleleve sipas gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, përsëri ekzistojnë të dhëna zyrtare që mjaftojnë për të nxjerrë (me probabilitet të lartë të saktësisë) përqindjet e popullsisë sipas ndarjeve etnike. Kështu, të dhënat për vitin shkollor 2013/2014 tregojnë se numri i përgjithshëm i nxënësve të shkollave fillore të Maqedonisë ishte 190.541 nxënës. Prej tyre, 122.924 mësojnë në gjuhën maqedonase, 61.298 në gjuhën shqipe, 5821 në gjuhën turke dhe 498 në gjuhën serbe. Por jo të gjithë nxënësit kanë etnitet të njëjtë me gjuhën në të cilën mësojnë. Përveç romëve, boshnjakëve, vllahëve, kroatëve dhe minoriteteve tjera joshqiptare që mësojnë në gjuhën maqedonase, në këto paralele nuk mungojnë as nxënësit shqiptarë dhe turq. Mirëpo, meqë mësimi organizohet edhe në këto dy gjuhë, është e mundur të identifikohet numri prej 1217 nxënës shqiptarë dhe 2811 turq që mësojnë në paralelet maqedonase. Të tjerët, në ndarjen e nxënësve sipas gjuhës dhe etnisë, i shtohen kontingjentit "maqedonase" e që do të thotë se në numrin prej 122.929 nxënës ose 64.5 përqind, jo të gjithë janë maqedonas. Përveç 1217

shqiptarëve dhe 2811 turqve, në këtë numër përfshihen edhe romët, vllahët, boshnjakët dhe të tjerë, të cilët veç e veç mund të jenë përqindje të vogla, por jo edhe bashkërisht. Në numrin e përgjithshëm të popullsisë, bashkërisht ato bashkësi etnike përbëjnë 5.3 përqind të popullatës. Logjikisht i bie që në klasifikimin 104.254 nxënës maqedonas, mbi 5.200 nxënës apo 5.3 përqind të mos jenë maqedonas e për pasojë - edhe përqindja reale e tyre të jetë 49.4 përqind. **Dominimi**/Arsimi në nivelin fillor, sikurse tregojnë të dhënat për numrin e nxënësve dhe paraleleve, zhvillohet në gjuhën maqedonase, shqipe, turke dhe serbe. Në paralelet maqedonase, me 122.929 nxënës, përveç maqedonasve dhe të tjerëve (104.209) ka edhe nxënës shqiptarë (1217) dhe turq (2811). Në paralelet shqipe me 61.298 nxënës, përveç shqiptarëve (60.787) ka edhe turq (81). Në paralelet turke me 5821 nxënës, përveç turqve (5630) ka edhe shqiptarë (184). Në paralelet serbe me 493 nxënës, përveç serbëve (448) ka edhe maqedonas (45 nxënës). Në shkolla mësohet edhe gjuha boshnjake, por si lëndë fakultative edhe atë në dy shkolla dy gjuhësore (maqedonisht dhe boshnjakisht) dhe në pesë shkolla tre gjuhësore (maqedonisht, shqip dhe boshnjakisht). E parë edhe në këtë prizëm, pra të ndarjes së shkollave sipas gjuhëve në të cilat zhvillohet mësim - janë

përsëri maqedonasit, respektivisht maqedonishtja që dominon arsimin fillor. Maqedonishtja shtrihet në 81.1 përqind të shkollave të Maqedonisë edhe atë nga 346 shkolla gjithsej - në 187 mësohet vetëm në maqedonisht, në 54 edhe maqedonisht edhe shqip, në 21 edhe maqedonisht edhe turqisht, në 2 edhe maqedonisht edhe serbisht, në 2 të tjera maqedonisht dhe boshnjakisht, kurse në 17 në maqedonisht dhe dy gjuhë të ndryshme. Maqedonishtja dhe paralelet maqedonase janë gjithë andej, ndërsa me numër dhe përqindje nxënësish janë shumë larg prezencës reale të tyre. Numri i nxënësve sipas përkatësisë etnike në njërin anë dhe në anën tjetër numri i paraleleve dhe numri i shkollave, janë treguesi më i mirë i kësaj. Madje, edhe sipas numrit të popullsisë janë shumë më pak se përqindja e shkollave ku mësohet maqedonisht në një, dy apo tre gjuhë. Nuk ndodh kështu me shqiptarët, të cilët edhe pse kanë 32.6 përqind të numrit të nxënësve, janë të përfshirë në vetëm 38 përqind të shkollave. Pra, shqip mësohet në 58 shkolla, në 54 shqip dhe maqedonisht, në 3 shkolla shqip dhe turqisht dhe në 17 shkolla shqip dhe dy gjuhë të tjera. Vetëm në një gjuhë, krahas 187 dhe 58 në maqedonisht dhe shqip, mësohet gjithashtu edhe në gjashtë shkolla të tjera, gjegjësisht në nga dy në turqisht, serbisht dhe boshnjakisht.

Armiqësia ndaj imigrantëve ka rrënjë të thella në psikologjinë njerëzore

Nga Victoria Esses (New Scientist)

Në shtator 2014, SHBA u përball me një krizë. Dhjetëra mijëra fëmijë të pashoqëruar nga Amerika Qendrore kishin kaluar kufirin me Meksikën në mënyrë të paligjshme dhe po mbaheshin në qendrat e ndalimit të imigrantëve. Pati debate të polarizuara dhe plot zemërim për mënyrën si duhej përgjigjur. Presidenti Obama e quajti një "krizë humanitare" dhe punoi për strehimin dhe ushqimin e fëmijëve. Të tjerë kundërshtuan përdorimin e burimeve të SHBA për t'u kujdesur për ta. Në pothuaj të njëjtën kohë, në Europë shpërtheu një grindje në lidhje me anijet e migrantëve në Mesdhe. Italia i pezulloi misionet e shpëtimit dhe Mbretëria e Bashkuar refuzoi të mbështesë një operacion të ri kërkim shpëtimit të BE-së, duke pretenduar se do të inkurajonte më shumë imigrantë që të përpiqeshin të kalonin detin. Agjencitë e ndihmës dhe Komisioneri i Lartë i OKB për Refugjatët u përgjigjën se këta operacione ishin të domosdoshëm për të shpëtuar jetë. Migrimi ndërkombëtar është një prej problemeve të mëdhenj socialë të ditës. Më shumë njerëz jetojnë jashtë vendit ku kanë lindur, se në cdo kohë tjetër në histori - 232 milionë në vitin

2013 - dhe ky numër pritet të rritet. Rritja e migrimit është rezultat i shumë tendencave globale, duke përfshirë rritjen e pabarazisë mes kombeve, kërkesës për krah pune në vendet ku ka rënie të lindjeve si dhe një rritje në numrin e refugjatëve dhe atyre që kërkojnë strehim. Kundërshtimi ndaj imigrimit është i përhapur në shumë vende perëndimore. Aktivistët anti-imigrim, media dhe elitat politike kanë krijuar një mentalitet krize në të cilin imigrantët paraqiten si "armiqtë tek porta". Imigrantët - sidomos jo të bardhët - paraqiten si fajtorë për të gjithë problemet e shoqërisë. Dhe kjo gjë nxit mbështetjen për platforma politike më ekstreme. Edhe imigrimi i paligjshëm është bërë objekt debatesh, me grupe si UKIP në Britaninë e Madhe që propozojnë kontrollime më strikte mbi migrantët nga disa pjesë të BE-së. Psikologët kanë shumë për të kontribuar sa i përket të kuptuarit se çfarë mund t'i ketë nxitur këto sjellje. Megjithatë, me pak përjashtime, kemi qenë të ngadaltë për të hyrë në këtë fushë. Nuk po fillojmë nga zeroja. Sjelljet dhe paragjykimet janë studiuar prej dekadash, dhe ka metoda eksperimentale për të shqyrtuar shkaqet në themel të tyre. Një zonë veçanërisht e rrahur e kërkimit

është ajo e rolit të konkurrencës në marrëdhëniet mes grupeve. Psikologët ka vite që e kanë debatuar këtë gjë. Në kontekstin e imigrimit, rezultoni që të jetë shumë e rëndësishme. Si rregull, pjesëtarët e grupeve socialë dominues kanë prirjen të besojnë se grupi i tyre është superior dhe si pasojë, ka të drejtën e burimeve dhe privilegjeve. Për të ruajtur dominimin e tyre, ata duhet të ngrenë "kufirin tek thana" ndaj grupeve "pushtues" që duket se konkurrojnë me ta për burime që janë të pamjaftueshëm, përfshirë vendet e punës, pushtetin politik si dhe ndikimin kulturor dhe fetar. Kjo mund të ndodhë pavarësisht nëse ka me të vërtetë burime të pamjaftueshëm dhe konkurrencë reale për ta. Ky besim në konkurrencën me shumë zero është qendror për sjelljet ndaj imigrimit. Ka një besim të përhapur se çdo fitim që kanë imigrantët duhet të vijë në dëm të anëtarëve të shoqërisë që i pret ata. Ky besim është i ngulitur thellë në shoqërinë perëndimore, ndonëse rrallëherë është i justifikuar. Kjo lloj sjelljeje merr formën e armiçësisë ndaj imigrantëve, "vetëfryrjes" - shpesh herë në formën e nacionalizmit - dhe mbështetjes për përjashtimin e imigrantëve dhe refugjatëve. Kur migrantët lejohen të vendosen në një vend

të ri, ata shpesh herë përballen me dilemën "hall të shkojmë, hall të mos shkojmë". Nëse janë ekonomikisht të suksesshëm, shihen si njerëz që u marrin vendet e punës vendësve; nëse nuk janë të suksesshëm, shihen thjeshtë si parazitë në sistem. Refugjatët dhe ata që kërkojnë strehim ka më shumë gjasa të shihen në mënyrë armiçësore. Studimet kanë treguar se temat më të zakonshme në media - duke përfshirë ankesat se kërkuesit e strehimit janë "të rremë" dhe të lidhur me kriminelë, terroristët dhe sëmundje - shkaktojnë dehumanizim. Ky perceptim i lejon disa në vendet pritëse që të thonë se refugjatët e meritojnë trajtimin e padrejtë dhe jonjerëzor që marrin. Këta reagime ndryshojnë në varësi të faktorëve të jashtëm që rrisin pasigurinë dhe ankthin, si dhe sfidojnë statusin e Recesionit ekonomik, fatkeqësitë natyrore dhe kërkesat për të drejta të barabarta për migrantët mund të theksojnë më shumë perceptimin për konkurrencën me shumë zero dhe rreziket nga jashtë. Shpërthimi i Ebolës, për shembull, ndihmoi për të ndezur ndjenjat anti-imigrim kundër hispanikëve në SHBA, ndonëse nuk ka patur raste të Ebolës në vendet e Amerikës Latine. Ndryshimi i këtyre sjelljeve nuk është i lehtë. Ne dimë që thjeshtë t'u thuash

njerëzve që imigrantët nuk po marrin burime, shkakton "kundërplasje". Kjo mund të ndodhë se besimi i "shumës zero" është i ngulitur thellë. Ndryshimi mund të jetë më i lehtë në vende të ndërtuar mbi imigrimin, si Kanadaja, SHBA dhe Australia. Duke u fokusuar në historinë e tyre, mbi atë që imigrantët e sotëm kanë të përbashkët me ata të djeshëm, si dhe në përfitimet që sjellin imigrantët, mund të ndihmojë për krijimin e një identiteti të përbashkët dhe qasje më pozitive. Megjithatë, kjo nuk do të funksionojë në vende si Mbretëria e Bashkuar, që nuk e shohin veten si të ndërtuar mbi imigrimin. Në këta vende, përpjekja për të përshkruar imigrantët si pjesë e një grupi brendashtetëror mundet që thjeshtë të përforcojë sjelljen negative. Ajo që është boll e qartë, është se imigrimi dhe kërkimi i strehimit nuk do të largohen. Vendet që integrojnë imigrantët me sukses kanë më pak gjasa të ndiejnë stresin dhe më shumë gjasa të marrin përfitimet. Janë të shumtë ata që e kanë kuptuar këtë gjë së fundmi dhe po zbatojnë politika të reja: Task Force e Obamës për Amerikanët e Rinj është një shembull. Ata vende që vendosin thjeshtë të përplasnin derën janë vënë në kërkim të telasheve. *Përkthimi në shqip u publikua së pari në "bota.al"*



EUROSIG

SIGURI E STANDARDEVE EUROPIANE

Adresa: Rr. "Papa Gjon Pali II-te", vila nr 5, Tirane, Shqiperi, Kutia Postare nr 126
Tel: (+355) 4 238 899/999, Fax: (+355) 4 223 841
www.eurosig.al, email: info@eurosig.al

- SIGURIM I AUTOMJETEVE
- SIGURIM KASKO DHE PAJISJE ME GPS
- SIGURIM NGA SEMUNDJET E AKSIDENTET
- SIGURIM I BIZNESIT
- SIGURIM I SHENDETIT NE UDHETIM
- SIGURIM I AKSIDENTEVE NE PUNE
- SIGURIM I GARANCIVE
- SIGURIM NGA ZJARRI DHE FATKEQESITE NATYRORE
- SIGURIM I MALLIT NE TRANSPORT
- SIGURIM I PERGJEGJESIVE
- SIGURIM I NXENESVE E STUDENTEVE
- SIGURIM I BANESES





Ka filluar fushata e abonimeve në gazetën "55". Ofertat e abonimeve jane:

1 muaj	900 lekë
3 muaj	2700 lekë
6 muaj	5400 lekë
1 vit	10800 lekë

Të gjithë të interesuarit që duan të abonohen në gazetën "55", të drejtohen pranë:
POSTA SHQIPTARE
AGJENSIA E SHPERNDARJES E SHTYPIT 1,2
ADRION LTD
TEL: 04/2321364 | CEL: 069 20 99 794



Shërbimi për fekondimin In Vitro tek “Koço Gliozheni”

Mjekët: E ka bllokuar Ministria e Shëndetësisë

Një shërbim i tillë për të realizuar fekondimin in vitro është bere gati edhe ne Spitalin Unversitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni” ne Tirane. Ky është bere i mundur fale financimit te Bashkimit Europian i cili ne vitin 2012 nisi projektin për ngritjen e një rrjeti qendrash mbi riprodhimin e asistuar ne gjashte vende te rajonit. Ne atë kohe u tha se puna për t'i ardhur ne ndihme prindërve te cilët nuk mund te kenë fëmijë ne mënyra natyrale do te niste një vit me pas. Por

ndonëse kane kaluar tre vjet ky shërbim ende nuk është vene ne funksion. Mjeket pranë maternitetit “Koco Gliozheni” i thane ABC News se gjithçka është gati, pavioni është pajisur me aparatura dhe mjeket janë trajnuar, por ajo qe ka bllokuar punën sipas tyre është se prej afro një viti Ministria e Shendetesise nuk publikon çmimet se sa do te kushtojë ky shërbim. ABC News pyeti drejtoreshën e maternitetit Rubena Moisiu, e cila tha se po prët një pergjigje nga Ministria

e Shendetesise ndërsa sipas ministrisë ne zyrat e saj nuk ka mbërritur asnjë shkrese zyrtare për këtë ceshtje. Ndërsa materniteti dhe ministria ja lënë pergjegjesine njëra-tjetrës ne vendin tone procedura e fertilitetit te ndihmuar medikalisht mund te kryhet vetëm ne klinika private ku kosto është e larte për te ardhurat mesatare te shqiptareve. Mjeket gjinekolog thonë se ne vendin tone janë rreth 15% e çifteve qe kane problem te sjellin ne jete fëmijë ne rrugë natyrale.



Infermierë nga Shqipëria ja si mund të punësohen në Gjermani

Shumë të rinj shqiptarë ëndërrojnë të jetojnë në Gjermani – por shanset për azil janë të ulëta. Një program i ri për infermierë synon të ofrojë një mundësi për të ardhur në Gjermani. Mund të përfitojë edhe Shqipëria

Shumë të rinj shqiptarë ëndërrojnë të jetojnë në Gjermani – por shanset për azil janë të ulëta. Një program i ri për infermierë synon të ofrojë një mundësi për të ardhur në Gjermani. Mund të përfitojë edhe Shqipëria.

Edhe pse ora është pesë pasdite mësuesi Endrit Mulaj nuk ka nevojë ta motivojë grupin e tij të gjermanishtes që të jenë të vëmendshëm në mësim – fjala është për temën “Të ardhurat dhe paratë” pra si thuhet në gjermanisht para, dëshmia e rrogës, tërheqje parash nga bankomati e kështu me radhë. Në klasën e institucionit mësimor “Inter Personel” në lindje të Tiranës janë këtë pasdite, shtatë gra të reja dhe tre burra – shumicës së tyre ua sheh në fytyrë se kanë lënë pas një ditë të lodhshme. Shumë prej tyre kanë ardhur direkt nga spitali se të gjithë ata që mësojnë këtu vullnetarisht tri orë në ditë gjermanisht, janë infermierë.

Ata përgatiten një vit me radhë për të ardhur në Gjermani, ku do të punojnë nga muaji tetor punë në spitale ose firma që ofrojnë shërbim përkujdeseni në shtëpi. Justin Toraku, 25-vjeç, tregon se pse po mëson

gjermanisht: “Unë punoj prej tre vjetësh në sallën e operacionit të Spitalit Universitar të Tiranës, por të ardhurat këtu nuk janë të mira. Në muaj fitoj 30.000 lekë, rreth 230 euro. Me këto nuk mund të mbijetosh këtu se është e vështirë. Në Gjermani natyrisht do të kem mundësi të tjera fitimi”.

Shkollim në bashkëpunim me partnerë gjermanë

Irina ka familje: bashkëshorti dhe tre fëmijë do të vijnë në Gjermani disa javë pasi ajo të ketë nisur punë. Edhe kjo është pjesë e konceptit të programit të Inter Personel: kursantët nuk lihen pas një viti mësimi në Shqipëri në mëshirë të fatit, por instituti organizon së bashku me një partner gjerman edhe vend dhe leje pune në Gjermani si dhe kujdeset edhe për banimin dhe strehimin e pjesëmarrësve të programit dhe të anëtarëve të familjeve të tyre. Në pesë qytete në Shqipëri marrin pjesë aktualisht në kurse 800 infermierë, thotë drejtori i institutit Musa Ahmeti:

“Në Gjermani mungojnë në spitale çdo vit deri në 10 000 infermierë. Kurse ne kemi në Shqipëri çdo vit rreth 2500 vetë që mbarojnë shkollimin



si infermierë dhe kujdestarë pleqsh. Në Shqipëri këto janë degë studimi me diplomë universitare. Por vetëm rreth 300 prej tyre gjejnë punë këtu, pjesa tjetër është në përgjithësi e papunë. Aktualisht në Shqipëri ka 20.000 infermierë të papunë (...) Ne vrasim disa zogj me një gur. Ne u ndërmjetësojmë këtyre njerëzve një punë të mirë dhe bëjmë diçka edhe për tregun gjerman

të punës. Po ashtu ne krijojmë një alternativë ndaj migrimit ilegal jashtë vendit.”

Shqipëria përfiton nga njohuritë e të kthyerve/ Shqipëria përfiton sipas Musa Ahmetit, jo vetëm nga ana e parave që emigrantët dërgojnë zakonisht në shtëpi, por edhe më shumë, në rast se emigrantët shqiptarë kthehen dikur përsëri në Shqipëri duke sjellë me vete përvojën e tyre. Një shembull

për këtë është mësuesi Endrit Mulaj. 39-vjeçari ka studiuar në Rostock gjermanisht dhe jetoi 12 vjet në Gjermani. Dëshira për të krijuar familje e ktheu atë sërish në vitin 2010 në Shqipëri. Ai thotë se nuk është penduar për këtë vendim dhe se u thotë kursantëve që pasi të shkollohen më tej në Gjermani të kthehen sërish në Shqipëri, sepse Shqipërisë i duhen ekspertë të tillë në të gjitha fushat./DW/

Ballkani që të lë pa frymë, Paste Magazine: Vizitoni Beratin



Bridget Nurre Jennions, e cila shkruan për Paste Magazine ka publikuar pjesën e dytë të artikullit të saj me titull “Një Ballkan që të lë pa frymë”. Pas artikullit të parë, në të cilin ajo kishte zgjedhur Sarandën si destinacion turistik kësaj here gazetarja e njohur reklamon Beratin. “Edhe pse rajoni është i njohur për konfliktet në vitin

1990, ai që e ka vizituar këtë cep të pazbuluar të Evropës Juglindore, e di se këto çështje kanë kaluar me kohë. Ata gjithashtu e dinë se dendësia e kulturës dhe bukurisë së virgjër që gjenden këtu janë mbresëlënëse.”- shkruhet në artikull.
Berati/Qyteti i Beratit është i mbrojtur nga UNESCO,

shtrihet mes maleve të Tomorit dhe Shpiragut dhe ka një historinë të gjatë. Ky qytet besohet të ketë qenë kështjella ilire e Antipatreia dhe është mbajtur nën syrin vigjilent të një kështjelle të importuar të epokës bizantine. I njohur si “Qyteti i një mijë dritareve,” tipari më i spikatur i Beratit është arkitektura e saj, me

rreshta prej fildishi dhe me shtëpitë të stilit osmane, që vijnë të gjarpëruara në rrugën e tyre deri në kodër, në kala. Sigurohuni që të ngjiten shkallët për te Kalaja, e cila ende mbetet një lagje tradicionalisht e krishterë e qytetit, së bashku me rreth një duzinë kisha dhe pak xhami.

Gjykata e Tiranës, në 2015-ën u trefishua numri i falimenteve

Personat fizikë hasin vështirësi për çregjistrimin e biznesit, kanë borxhe në tatime

Çështjet e falimentit në Gjykatën e Shkallës së Parë gjatë vitit 2015 pothuajse u trefishuan. Statistikat tregojnë se u regjistruan në total 64 çështje nga rreth 22 që ishin në vitin 2014. Mungesa e gjyqtarëve të specializuar për çështjet e falimentit ishte një ngërç më vete dhe pengonte jo pak trajtimin dhe përfundimin e çështjeve. Për këtë qëllim për herë të parë në vitin e kaluar u ngrit një seksion i posaçëm për të gjykuar çështjet tregtare dhe të falimentit. Në bashkëpunim edhe me IFC-në (Banka Botërore) u bë e mundur edhe trajtimi i gjyqtarëve. Aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë po trajtohen çështjet e falimentit për emra të njohur kompanish, si ajo për Kurum, Albania Airlines, Praktiker Albanien, Volalba, Italcrom, Vaporusa-Alb, etj. Nga të dhënat vihet re se në total kjo gjykatë gjatë 2015-ës regjistroi mbi 38,700 çështje, ku pjesa më e madhe mbi 27,000 ishin me subjekt civil. Sa i përket çështjeve të përfunduara numri i tyre u rrit me rreth 6% në krahasim me periudhën paraardhëse. Në total norma e likuidimit u llogarit në rreth 98%. Në po këtë shkallë

rritje të çështjeve të regjistruara pati edhe për natyra të tjera, ku bie në sy ajo për "Vjedhjen e energjisë dhe impulseve telefonike". Gjatë 2015-ës u regjistruan si të tilla mbi 1,400 çështje nga rreth 158 që ishin në vitin 2014. Një shifër e cila tregon tendencën e fushatës së realizoi qeveria kundër vjedhjes së energjisë.

Vështirësi për çregjistrimin e biznesit/Në sportelin e QKR-se kohët e fundit janë shtuar kërkesat për çregjistrimin e bizneseve, por personat e interesuar po shohin se të çregjistrohesh është më vështirë se të regjistrohesh. QKR, në bazë të ligjit, ka sqaruar se detyrohet të refuzojë kërkesat për çregjistrimi pasi bizneset duhet që më parë të kenë shlyer të gjitha detyrimet tatimore. Por bizneset në sportelet e QKR, kryesisht persona fizike pohojnë se duan të mbyllin aktivitetin për shkak se nuk kanë aftësi paguese të detyrimeve. Për shoqëritë tregtare edhe kur janë borxhlije në tatime falimenti kalon me një proces të kërkuar në gjykatë nga tatimet ose nga vetë ndërmarrja në faliment, por personat fizik kjo procedurë është e pamundur për shkak të



kostove dhe të procesit të gjatë. Por ndërkohë që bizneset e vogla nuk arrijnë çregjistrimin, borxhi tatimor i tyre vijon të rritet ndonëse ata nuk kanë aktivitet. Violeta që në vitet 2000 kishte hapur vetëm për 1 vit një dyqan me aroma indiane sot është debitor me rreth 1 milionë lekë në tatime vetëm se nuk ka arritur të çregjistrojë

biznesin. QKR-ja njofton se për personat fizikë, çregjistrimi në mënyrë vullnetare kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim. Ky aplikim mund të bëhet së bashku me njoftimin e pushimit të aktivitetit ekonomik ose në një moment të dytë. Por kjo vetëm në rast se llogaritë me tatimet dhe pushtetin lokal duhet janë të

pastra. Kërkesat për çregjistrim janë shtuar në muajt e fundit, teksa 91 mijë biznese (50% e totalit të bizneseve) kanë kaluar në regjistrin pasiv. Procedurat e komplikuar të çregjistrimit të biznesit janë ndër rekomandimet kryesore të Bankës Botërore për përmirësimin e klimës së biznesit.

Subvencionet për 2016-ën, 13 milionë euro

USAID mbështet me financime projekte në sektorin e bujqësisë

Kur kriza e prodhimit ka mbërthyer disa sektorë, bujqësia duket hapësira me më shpresë për prodhim e shitje. Në mbështetje të këtij sektori së fundi është edhe një nga programet e USAID,

"Agrokapital". Në një takim me përfaqësues të fushës drejtuesit e programit theksuan se është mposhtur mosbesimi për investimet në bujqësi. Ministri i Bujqësisë Edmond Panariti theksoi se fondet qeveritare në

mbështetjen direkte janë rritur, ndonëse sektori është ende më pak i mbështetur në rajon. Kete vit subvencionet pritet të jene 13 milionë euro, ndërsa Agrokapital ka lehtësuar financimin për rreth 20% të aplikanteve.

Konfindustria kërkon ndryshimin e kategorizimit të bizneseve sipas xhiros vjetore

Konfindustria do të paraqesë si një nga kërkesat kryesore për Paketën Fiskale 2017, ndryshimin e kategorizimit të bizneseve sipas qarkullimit vjetor – si veprim i domosdoshëm për formalizimin e ekonomisë. Kështu bëri të ditur Administratori i Përgjithshëm i saj, Gjergj Buxhuku. "Legjislacioni në fuqi kategorizon bizneset në të ashtuquajtur "te vegjël" me qarkullim vjetor deri në 5 milionë dhe 8 milion lekë, që përfitojnë përjashtim të plote dhe ose pjesor nga tatimet, – tha Buxhuku. – Konfindustria, mbështetur në praktikën e vendeve themeluese me të zhvilluara të BE do të kërkojë,

që zbatimi i përkrahjes fiskale për bizneset e ashtuquajtur te "vegjël" të mbështetet në fitimin dhe jo qarkullimin vjetor. Konfindustria vlerëson, se ndarja e sotme ka shtuar ndjeshëm rezistencën e bizneseve te "vegjël" për mosleshimin e faturave tatimore për biznesin e "madh", duke shkaktuar drejtpërdrejt prodhim të evazionit fiskal në gjithë ekonominë vendore. Bizneset, në pamundësi për shkarkimin e faturave dhe përballë rrezikut të falimentit, detyrohen të fshehin shitjet, të hyjnë në spiralen e evazionit dhe si rrjedhim të jene lehtësisht të goditshem nga institucionet fiskale, duke

krijuar kushte objektive edhe për korrupsion. Pasojat e dukurisë se mësipërme janë të renda për ekonominë vendore, sepse ajo ve në pozite të vështirë biznesin "e madh", ul të ardhurat për buxhetin e shtetit, minon aksionin e ekzekutivit për luftën kundër informalitetit, rëndon mjedisin e biznesit dhe ul konkurrencën e vendit për tërheqjen e investimeve. Shqipëria radhitet në vendet e fundit në rajon për investimet e huaja, shkalla e evazionit fiskal arrin deri në 50% të PBB dhe mosrealizimi i të ardhurave buxhetore në vitin 2015 ishin në nivelin historik me të lartë prej afër 400 milionë USD," përfundoi Buxhuku.

Çmimi i kafesë i kthehet rritjes, shkak ngarkesa fiskale nga taksat vendore

Edhe pse nën presionin e uljes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, çmimi i kafesë në lokale dhe bare ka reaguar me rritje këtë vit. Produkti më miqësor për shqiptaret, kafeja ka qenë në trajektore rënës gjatë vitit që shkoi, por tani kurba i është kthyer rritjes. Të dhënat e INSTAT tregojnë se rritja vjetore të çmimeve për kafënë ishte 1.1%, vlera më e lartë që 2014. Ky ndryshim një vit më parë ishte 0.4 për qind. Burimet nga tregu pohojnë se shkaqet e rritjes së çmimeve lidhen me nismën e antiinformalitetit dhe rritjen e taksave vendore. Barra fiskale në fillim të këtij vit është dyfishuar për bizneset e vogla, të cilat duket se kanë nisur të reflektojnë këto masa në rritjen e çmimeve. Të dhënat e importit për tremujorin e parë tregojnë se kafeja nuk është prekur nga kriza e konsumit. Për janar-mars janë importuar 2.4 për qind më shumë se e njëjta periudhë më parë. Kafeja është nga të paktat produkte që nuk është prekur nga kriza. Që kur qeveria në vitin 2009 nisi të lehtësojë taksimin me akcizë mbi kafene, importet e saj krahasuar me këtë vit gati janë dyfishuar. Si për të gjithë mallrat e tjerë të akcizës edhe për kafënë niveli i taksimit ka ndryshuar disa herë. Nga 30 për qind të vlerës së importit në 1996 akciza u bë fikse në 2003. Në vitin 2013 vlera e akcizës u rrit, ndërsa lehtësimi nisi pas 2010. Duke ndjekur modelin e shumicës së vendeve të BE në 2012 akciza për kafënë e papjekur u bë 0 nga 30 lekë kilogrami që ishte, ndërsa për kafënë e papjekur taksimi me akcizë u ul ndjeshëm.



Katastrofa e arkivave të shtetit shqiptar në vitet 1944-1964

Raporti i vitit 1961: Arkivat rrezikohen të zhduken

Këshilli i Ministrave konstatonte se fondi arkivor ishte dëmtuar rëndë fizikisht, mungonin godinat, kuadri i përshtatshëm, mjetet teknike, etj, problematika që hasen edhe sot në të njëjtat përmasa

Nga Kastriot Dervishi

Paaftësinë e një klase politike për të qeverisur e tregon niveli i arkivave. Sigurisht askush nuk pretendon se me ardhjen e komunistëve në pushtet Shqipëria u qeveris. Përkundrazi, Shqipëria vetëm u nënshtrua nga një grup banditësh që vetëm me shtetin nuk kishin lidhje. Shqipëria e shkatërrua, u vra dhe u vodh në mënyrën më të paimagjinueshme. Për këtë arsye fytyrat e shqiptarëve ishin të jashtëzakonshme për keq në sytë e ndërkombëtarëve, kur këta njohën "Shqipërinë socialiste", "kalanë e pamposhtur" që ra si kështjellë rëre në fundin e vitit 1990. Në këtë taksirat që i ra Shqipërisë me komunistët, arkivat nuk mund të ishin të përkryera. Është mirë që këtë informacion ta kenë sot organe të ndryshme të cilat i kërkojnë qytetarëve dokumente që nuk ekzistojnë.

Institucioni i arkivave nga tjetër nuk po mundej të futej në rrjedhë normale pune. Grindjet e brendshme, mungesa e personelit, paqartësia për të ardhmen, etj, ishin disa nga çështjet që ata përballeshin në fund të viteve '50. Sigurisht të vetmen gjë që ia kishin ngenë komunistët ishin mbledhjet e gjata e të pafundja. Komiteti i PPSH-së së MPB-së morri në trajtim çështjen ("qëndrime e sjellje jokorrekte të shokut Veli Dedi ndaj urdhrave të ministrit dhe sjelljeve jo të mira me vartësit") e drejtorit të Drejtorisë së Arkivave Veli Dedi më 24.4.1962. Njoftohej sekretari i KQ të PPSH-së Rita Marko dhe sekretari i parë i Komitetit të PPSH-së së qytetit të Tiranë, Rrapo Dervishi. Ndër të tjera thuhet: "Gjatë kohës që shoku Veli Dedi punon në drejtorinë e Arkivave të Shtetit, ka bërë përpjekje në krye të atij kolektivi për të kryer detyrat e rëndësishme që u janë ngarkuar për të kryer detyrat e rëndësishme që u janë ngarkuar për të grumbulluar, sistemuar, ruajtur dhe shfrytëzuar materialet dokumentare. Por në punën e shokut Veli dhe sidomos në sjelljet dhe trajtimin e vartësve, si në të kaluarën dhe tani, ka manifestuar e manifeston". Sekretari i organizatës bazë të PPSH-së Hajdar Aranitasi shkruan mbi çështjet që ngrihen ndaj drejtorit. Shkruhet se ai nuk shkon mirë me Ali Progrin dhe



nëndrejtorin Xhavit Strugën për çështjen e komisioneve të përhershme, gjë që na jep të kuptojmë se sherrat janë më parësore sesa

Riorganizimi i vitit 1961

Si rrallë herë problemi u diskutua në Këshillin e Ministrave. Mjafton të lexosh këtë VKM nr.109, datë 21.4.1961, mbi riorganizimin e arkivave për të mësuar se në çfarë katastrofe ishin dokumentet këtë kohë. Midis të tjerash në vendim thuhet: "Gjendja e arkivave është e pakënaqshme mbasi shumë dokumente të grumbulluara janë në rrezik të dëmtohen rëndë fizikisht e të zhduken për mungesë të godinave, lokaleve dhe mjeteve teknike të nevojshme, për mungesë

kuadri të përshtatshëm e të mjaftueshëm në numër si dhe për pakujdesinë e drejtuesve të institucioneve shtetërore e shoqërore. Si rrjedhim kjo ka penguar dhe ka kufizuar grumbullimin, sistemin dhe shfrytëzimin e materialeve arkivore si burimi kryesor për studimin e shkencave të ndryshme shkencore të historisë së popullit tonë". Thuhet se vendimet bazoheshin në orientimet e Byrosë Politike. Në janar 1962 u vendos që Drejtoria e Arkivave të kalonte në autonome brenda MPB-së. Po ashtu u vendos funksioni i kryearkivistit për çdo institucion qendror e vendor. U shtuan 10 kuadro, si dhe bashkëpunimi me Universitetin Shtetëror të Tiranës. (AQSH, F.490, V.1961, D.126).

Në vijim të kësaj VKM-je ministri i Punëve të Brendshme, Kadri Hazbiu, me urdhrin e datës 4 nëntor 1961, urdhëroi konsiderimin e Drejtorisë së Arkivit të Shtetit, si drejtori autonome në varësi të MPB-së me limit organik deri 65 vetë. (AMB, F.48, V.1961, D.525, fleta 1).

Kategorizimi i dokumenteve, viti 1962

Pas këtij urdhri nisi një lloj stabilizimi e gjendjes. Më 5.3.1962 me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, kryeministri miratoi më 21.4.1962 kategorizimin e materialeve dokumentare të MPB dhe afatet e ruajtjes së tyre. Sipas kësaj skeme, dokumentet ndaheshin në dy grupe:

DOSSIER



1-Grupi i Parë: dokumente tepër sekret e sekret. Këto dokumente duhej të ishin sa më të shkurtra dhe gjithmonë merreshin me vete.
2-Grupi i Dytë: kishte dokumente të ndarë në dy kategori:
a-Kategoria "A" ku bënin pjesë dokumentet të rëndësishme me vlerë operative dhe historike që mund të mos përdreshin dhe që siguroheshin para kohe të vende të posaçme.
b-Kategoria "B", në të cilën hynin dokumente të rëndësishme me vlerë operative e historike që nevojiten të shërbenin, të cilat mikrofilmohen.
3-Grupi i Tretë përfshihen dokumente që në rast se nuk mund të siguroheshin, asgjësoheshin me urdhër të shefave të organeve qendrore e të periferisë.
4-Grupi i Katërt përfshinte dokumente që u kishte kaluar afati e duheshin asgjësuar.

Viti 1962, arkivat në varësi të Këshillit të Ministrave

Pasi dështoi eksperimenti i varësisë së rrjetit arkivor nga Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave vendosi më 5.6.1962, krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, në varësi të Këshillit të Ministrave. Drejtori Veli Dedi, ia la vendin Dhimitër Kotinit. Për të krijuar lehtësi të tjera, me VKM, nr.89, datë 21.3.1964, Këshilli i Ministrave, "Mbi krijimin e arkivave të Ministrisë

së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme", u krijuan arkivat e sistemit. Këto arkiva u ngarkuan të administrojnë dokumentet që krijojnë organet e tyre. Institucionet e tjera shtetërore nuk mund të mbanin dokumentacionin e tyre, më tepër se 10 vjet pas datës së qarkullimit.

Aktet nënligjore

Me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.30, datë 24.1.1963, u vendos: "Drejtoria e Përgjithshme të Arkivave Shtetërore është institucioni që varet drejtpërdrejtë nga Këshilli i Ministrave dhe që administron fondin dokumentar arkivor të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qendër organizuese dhe shkencore-metodike e udhëheqjes së gjithë veprimtarisë në punën arkivore në Republikën Popullore të Shqipërisë". Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore u përcaktuan: a-të organizojë dhe të zbatojë masa për grumbullimin, ruajtjen, sistematizimin dhe shfrytëzimin shkencor të fondit dokumentar arkivor të shtetit dhe të bëjë shpërndarjen e tij në arkivat përkatëse. b-të organizojë përcaktimin shkencor të metodave të ruajtjes, sistematizimit dhe sigurimit të materialeve dokumentare arkivore,

që ruhen pranë Arkivave qendrore, në arkivat e përkohshme të ministrive, institucioneve qendrore, komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, ndërmarrjeve dhe organizatave shtetërore e kooperativiste të të gjitha instancave. c-të ushtrojë kontroll mbi gjendjen, mbajtjen e evidencës, ruajtjen, sistematizimin dhe shfrytëzimin e fondit dokumentar arkivor të shtetit, ç-të informojë institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat e interesuara mbi përbërjen dhe përmbytjen e dokumenteve të fondit dokumentar të shtetit, të organizojë shfrytëzimin e tyre në dobi të shkencës, ekonomisë dhe kulturës, si dhe të përpilojë buletinet shkencore etj. d-të organizojë ekspertizën e vlerës shkencore dhe praktike të materialeve të fondit dokumentar të shtetit, që duhet ti nënshtrohen ruajtjes së përkohshme ose të përhershme, si dhe të atyre që nuk paraqesin interes për ruajtje të mëtejshme, e-të lehtësojë kërkesat e organeve operative dhe të informojë këto organe mbi dokumentet që paraqiten interes të veçantë. f-të lëshojë certifikata, riprodhime, ekstrakte dhe kopje të dokumenteve që do të kërkohen nga institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat ose nga persona privatë".

Me VKM nr.31, datë 24.1.1963, u miratua Rregullorja e

Këshillit Shkencor. Me VKM nr.33, datë 24.1.1963, u miratua Rregullorja e Komisionit Qendror të Ekspertizës i cili përbëhej nga "punonjës të kualifikuar" dhe drejtohej nga zëvendës-drejtori i Arkivit. D.56.

Struktura e vitit 1963

Me VKM nr.78, datë 27.2.1963, struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit të Shtetit. 30 veta me vendim të Byrosë Politike nr.319, datë 21.9.1960 do qëndronin për 6 vjet aty. Struktura ishte kjo:
1-Drejtori, paga 17.200 lekë.
2-Zëvendës-drejtori 14.200.
3-Dega e organizim-inspektimit
4-Dega e kuadrit dhe administratës
5-Arkivi Qendror Historik:
-Sektori i dokumenteve sekrete para vitit 1944
-Sektori i dokumenteve të periudhës para vitit 1912
-Sektori i dokumenteve të periudhës së viteve 1912-1944
6-Arkivi Qendror Shtetëror:
-Sektori i dokumenteve sekrete para vitit 1944
-Sektori i fondeve të dokumenteve të organeve të larta e të ulëta shtetërore.
7-Zyra e Ruajtjes së dokumenteve.
Gjithsej organika me 72 veta. (AQSH, F.490, V.1963, D.98)

Këtu fillon stabilizimi i dokumentacionit që ka mbërritur deri në ditët tona. Natyrisht me keqardhje duhet ta pranojmë që duhet të gëzohemi që erdhën deri ditët tona edhe këto dokumente.



DOSSIER



Në 90-vjetorin e lindjes së tenorit të mirënjohur "Mjeshtërit të Madh" Kristaq Paspali (1926-2016)

Artisti shqiptar i teatrit "Balshoi"

"Ishte shqiptari i parë dhe i vetmi që interpretoi me sukses si solist i parë në "Balshoi Teatër" e që i mahniti me zërin e talentin e tij. Shtypi rus i kohës i bëri jehonë shumë të madhe debutimit me sukses të artistit të madh shqiptar, duke e vlerësuar si një tenor të veçantë me një zë të fortë e natyral"

Nga Flori SLATINA

Sot është 90-vjetori i lindjes së një prej tenorëve të shquar të skenës shqiptare, Kristaq Paspalit, një personalitet që me zërin dhe artin e tij la gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e spektatorit dhe që shënoi historinë e artit operistik shqiptar. Ky artist, për afro një gjysmë shekulli, në skenë dhe jashtë saj, në opera dhe koncerte, brenda dhe jashtë vendit, përfaqësoi më së miri artin e popullit të tij. Ishte artist i palodhur, që natyra i kshte falur një zë të mrekullueshëm dhe që me punën dhe talentin e tij krijoi role të papërsëritshme dhe emocione të fuqishme tek të pranishmit.

Ai ishte shembulli i artistit, që vjen nga shtresat e varfëra, shembulli i artistit që e nis në kushtet ekstreme të varfërisë dhe mjerimit, por që falë talentit e zotësisë së tij, çau në jetë dhe u bë një personalitet i rëndësishëm i skenës shqiptare. U vlerësua me tituj, çmime, urdhra e medalje, ishte pjesë e dhjetëra artikujve në gazeta, emisione televizive dhe koncerte e shfaqje të skenës shqiptare. Viti 2016 shënon njëherësh edhe 15 vjetorin e ndarjes së tij nga jeta dhe ky shkrim homazh është një mirënjohje e respekt për artin e tij.

Kristaq Paspali u lind në 19 maj 1926 në Vlorë. Që i vogël shquhej për zërin e tij të bukur e të veçantë. Këngët e belbëzimet e para i ka mësuar nga nëna. Njohuritë e para i mori në shkollën fillore në Vlorë, të cilën ishte i detyruar ta ndërpriste. "Më pëlqente të këndoja në shkollë me korët e nxënësve, por dëshira ime u pre shumë shpejt". Mbetet jetim në moshë të njomë dhe i detyruar nga kushtet ekonomike futet si çirak në Vlorë tek tregëtarët Sallata, vetëm e vetëm për të ushqyer veten e vëllanë e vogël. Në fillim të viteve 40-të, Paspali, me tezgën krahu mbushur me petulla e me një torbë në dorë me cigare e uzo, ashtu gjysme i zhveshur e i zbathur, shëtiste vend më vend, kodër më kodër, kudo ku kishte ushtarë italianë për të shitur diçka e për të jetuar. "Kur kthehesha në darkë këmbët i kisha gjak, -kujtonte i përplotur Paspali. Punët e rënda ma zhdokën dëshirën dhe e ndieja veten të ndrydhur. Kur rashë në kontakt me ushtrinë italiane mësova ariet e këngët e bukura italiane". Një ditë kur po këndonte e dëgjon prifti dhe e mori në korin e kishës, për një copë bukë. Aty mëson e këndon këngët fetare, por edhe Bahun, Mozartin, Schubertin etj. "Nga vitet 43-44 flitej shumë në qytet



Akti i parë i operes Rigoletto, dueti Xhilda- Dukës se Mantoves (Nina Mula-Kristaq Paspali)

për partizanët dhe vendosa edhe unë të dal partizan për të luftuar armikun, ndonëse isha i vogël. Kam qënë korrieri i Divizionit VI. Në mal ashtu pas çdo beteje, kur kishim kohë të lire, këndonim së bashku me të paharruarin Mentor Xhemali, këngët e kohës, partizane, këngë dasme, kurbeti etj». Mbas Luftës Divizioni i V dhe i VI, vendosen në Korçë, dhe aty Paspali pati mundësinë të angazhohej me grupet amatore të Korçës. "Më pas erdha në Tiranë tek vëllai i madh, ku punova përsëri si çirak, por pasi ai u martua shkua në Durrës, (Shkozet). Fillova punë si shofer e traktorist në portin e Durrësit". Këtu iu dha mundësia që të shfaqte zërin e tij të mrekullueshëm, ashtu tek këndonte që nga maja e vinçit, siç kujton ato vite Paspali, e që mahniti jo vetëm ata që e rrethonin, por edhe të huajt që vinin shpesh me anije. Kompozitori i njohur i qytetit të Durrësit Pjetër Dungu i mahnitur nga zëri i tij e zbuloi talentin e madh dhe e praktikoi si solist të parë në korin e shtëpisë së kulturës në Durrës si dhe në operat. Në Durrës Kristaq u angazhua disa vite me radhë me zërin e tij të mrekullueshëm, duke dhënë koncerte në Durrës e në rrethet e qytete të tjera të vendit. Në një festival të këngës së lehtë, ku ai mori çmim të parë, specialistët i sugjerojnë Liceun Artistik, si e vetmja shkollë profesionale në

atë kohë. Vazhdoi studimet në Liceun Artistik "Jordan Misja" në 1950-1954, me profesoren e nderuar (AP) Marie Kraja. "Atëherë isha i martuar me dy fëmijë dhe nuk mund vazhdoja shkollën pa një rrogë. Mu akordua, por mu ndërpre pas një viti. Desha ta lë shkollën, por ishte ime shoqe, Kaliroi, që sakrifkoi duke punuar që unë të vazhdoja shkollën e të mos e braktisja artin." Pas studimeve Kristaqi emërohet në Filarmoninë e Shtetit. Kristaq Paspali ishte solisti i parë e i vetëm i saj, duke interpretuar për vite me radhë, mbi 30 role në operat botërore e të autorëve tanë e mbi 12 000 koncerte. Ai është pioneri i artit operistik dhe ndër të parët që ka aplikuar koncertet recitale, mbi një orë e gjysmë, duke kënaqur me zërin e tij publikun e shumë të qe mbushte plot sallën, çdo natë, e që e duartrokiste gjatë. Ishte interpretues i të gjitha zhanreve. Roli i tij i parë ka qënë opera "Nusja e shitur". "Unë luajta rolin e Vashekut, një gagaçi, çka supozonte një rol të vështirë e që pati sukses." Për dy sezone rresht ai interpretoi me sukses përmes një stërmundimi e lodhjeje të madhe, aqsa në një opera i plasi vena në sallë. "Kënaqësia ime më e madhe ka qënë publiku që më ka duartrokur gjatë." Në vitin 1958 shkon për specializim në BS në Moskë. "Vajtja ime në BS ishte një ëndër. Unë këndoja në Moskë në një koncert festiv, siç bëheshin në

raste të veçanta në atë kohë. Ka qënë viti 1959 dhe këndoja në sallën e Universitetit prestigjioz "Lomonosov" të Moskës. Atë mbrëmje më dëgjoi Pakrovski, dirigjenti dhe regjisori i madh sovjetik me famë botërore, pedagog i institutit dramatik "G.I.T.I.S", i cili më propozoi të bashkohesha me trupën e "Balshoi Teatër". Së bashku me Piro Manin (AP), u paraqitëm, pasi ai dinte mirë rusisht, ku unë fitova në provat dhe m'u dhanë të gjitha të drejtat për në "Balshoi Teatër". Këndova si solist i parë në dy opera "Kavaleria rustikana" dhe "Paliacci". Kristaq Paspali ishte shqiptari i parë dhe i vetmi që interpretoi me sukses si solist i parë në "Balshoi Teatër" e që i mahniti te terë me zërin e talentin e tij. Ky artist i madh me zërin e tij nderoi jo vetëm veten, por edhe vendin e tij, Shqipërinë. Shtypi rus i kohës i bëri jehonë shumë të madhe debutimit me sukses të artistit të madh shqiptar, duke e vlerësuar si një tenor të veçantë me një zë të fortë e natyral. Gjithashtu ai përparoi edhe operat "Damapik", "Otello", etj, por që nuk mundi dot t'i këndonte me zërin e tij magjik. Ziliqarët, partiakët e Ambasadës sonë në Moskë, në vend që të gëzoheshin e të kënaqeshin me artistin e madh, bëjnë të kundërtën, duke dëshmuar shpirtin e keq dhe injorancën e tyre. E detyrojnë Paspalin të kthehet në atdhe duke e kritikuar, pse këndoi

italisht operat, në një kohë ku të gjitha operat në botë këndohen në gjuhën e tyre. Kthimi i tij në atdhe çuditi edhe vetë sovjetikët. Momente të vështira për një artist të madh. E keqja vazhdon në Tiranë. Në vend që ti jepnin një tufë lule e detyrojnë të punojë si puntor skene në TOB dhe herë pas here e angazhojnë në korin e operas. "Ka qënë një periudhë me stresse, derisa në Tiranë erdhën të ftuar nga vetë kreu i shtetit, profesorët e mëdhenj të muzikës, themeluesi i Liceut francez të Korçës, Decorville dhe italiani Squipa. Të huajti i shoqëronin Baki Kongoli dhe Llazar Siliqi. Ata kishin dëgjuar për mua që kur isha në BS dhe u çuditën me fatin tim të prapshhtë. Ata i kërkuan drejtorit të saj kohe të TOB, Kostandin Trakos, që të interpretoja në skenë e jo në kor. Kjo ka qënë ndërhyrja e parë për mua." Por ndërhyrja më e madhe ka qënë një peticion me reth 11 000 firma intelektualësh dhe studentësh të Shqipërisë i cili kërkonte ngjitjen në skenë të artistit të madh Paspali. Një peticion shumë i rrallë për kohën e që e tetyroi regjimin të vinte nderin në vend. Kjo nuk kishte ndodhur asnjëherë në historinë e muzikës. Një gjysme shekulli me këngë në gojë. Në karrierën e tij të pasur si artist do të interpretojë më vonë 23 role kryesore të kryeveprave operistike si: "Palaci", "Kavaleria Rustikana", "Karmen", "Bohema", "Toska", "Rigoletto", "Traviata", "Toska", "Ciganët", etj. Përsëri ndodhin të papritura me artistin. Largohet befasisht nga teatri "në pension" në moshën 48-vjeçare, kur ishte në kulmin e karrierës. "Unë ndihesha mirë me zërin tim. Me skenë ishim bërë si binjakë». Në vitin 1991 sikurse edhe shumë shqiptarë artisti shkon në Greqi. Në Operan e Athinës konkuron midis 70 pjesëmarrësve dhe fiton vend të parë si solist. Suksesi qe një befasi për antarët e jurisë dhe vetë artistin. Në vitin 1994 i jepet titulli "Artist i Merituar", kur ai ka kohë që është artist i popullit të tij. Me rastin e 70-vjetorit të lindjes ish-presidenti Meidani e nderoi me titullin e lartë "Mjeshtëri i Madh". U shua në vitin 2001, duke qënë gjithmonë i rrethuar mes familjes, gruas së tij të dashur, së cilës i dedikonte çdo gjë, vajzave artiste, djalit, mbesave e nipërve të tij. Tenorë si Kristaq Paspali rrallë i vijnë skenës. Nuk dihet se kur skena e TOB do të ketë një artist e një zë të tillë... Ndaj edhe sot, në 90-vjetorin e tij të lindjes e kujtojmë dhe nderojmë me respekt artistin që, mbi të gjitha, nderoi e lartësoi emrin e Shqipërisë në botë.

“Zhulieta pa Romeun”, shfaqja që trajton temën e të zhdukurve në luftë nga Baleti Kombëtar i Kosovës

“Fillimisht projekti është Romeo e Zhulietë, por kur e mendova për këtu pra në Kosovë, dhe kur mendova për balerinët të cilët i njoh mirë dhe e di biografinë e tyre dhe gjithashtu e di situatën në Kosovë ku është më e lehtë ta perceptosh nëse vjen nga jashtë, pra që nuk je i ndikuar nga lufta që ka ndodhur këtu e ke më lehtë të krijosh. Dhe kështu e di që ende shumë njerëz mungojnë, janë të zhdukur në luftë pra vendosa që projektin ta shndërroj në “Zhulieta pa Romeun” apo “Dashuria pret gjithmonë”, filloi tregimin e storjes për KultPlus, koreografi Darrel Toulon

Herën e parë që erdhi në Kosovë krijojë një shfaqje mbi temën e luftës së fundit në vend. E duket se historitë e treguara i lanë përshtypje të madhe edhe për një shfaqje tjetër, e sidomos fotografitë e vendosura në sheshin Ibrahim Rugova, që tregojnë fytyrat e të zhdukurve tash e 17 vite. “Zhulieta pa Romeun”, është titulli i premierës së dytë për këtë vit të Trupës së Baletit Kombëtar të Kosovës, e që kjo shfaqje solli për herë të dytë në Kosovë, koreografin nga Austria Darrel Toulon.

“Fillimisht projekti është Romeo e Zhulietë, por kur e mendova për këtu pra në Kosovë, dhe kur mendova për balerinët të cilët i njoh mirë dhe e di biografinë e tyre dhe gjithashtu e di situatën në Kosovë ku është më e lehtë ta perceptosh nëse vjen nga jashtë, pra që nuk je i ndikuar nga lufta që ka ndodhur këtu e ke më lehtë të krijosh. Dhe kështu e di që ende shumë njerëz mungojnë, janë të zhdukur në luftë pra vendosa që projektin ta shndërroj në “Zhulieta pa Romeun” apo “Dashuria pret gjithmonë”, filloi tregimin e storjes për KultPlus, koreografi Toulon, e tij në shfaqje do ta pret gjatë tërës Romeun.

Për koreografin kjo është një punë goxha intensive, edhe pse ai e sqaroi se balerinët e kanë më lehtë sepse ata e kanë përjetuar

pra sipas Toulon balerinët e Trupës së Baletit të Kosovës, ngjarjet e luftës vetëm duhet ti kujtojnë, edhe pse e kanë vështirë, pasi që, në atë kohë ata kanë qenë shumë të rinj.

“Për mua është shumë me rëndësi të koncentrohem në njerëzit me të cilët jam duke punuar, dhe kështu po mundohem të shikojë shumë brenda tyre që ta nxjerrë atë personale dhe atë më të bukurën që ta prezantojmë”, tha më tej Darrel Toulon, i cili poashtu tha se e dinë që ka ende shumë nëna duke pritur për një Romeo që të kthehet dhe ka shumë Zhulietë duke pritur gjithashtu, por që, për të kjo është shumë emocionale që të bëjë art me këtë ngjarje. “Arti të lejon çdo gjë, ta jep këtë hapësirë që të krijosh lloj lloj gjëra, e ato të mbetën edhe për shumë kohë në kujtesën e njerëzve që ndoshta nuk janë të prekur me këto ngjarje”, u shpreh koreografi duke theksuar edhe njëherë se është shumë i nderuar që i është dhënë rasti të punoj në Kosovë.

Por, përkundër shfaqjeve të tjera që janë punuar nga Trupa e Baletit të Kosovës e që janë dhënë premierë në Kosovë, kjo shfaqje përpos premierës që do ta ketë në Teatrin Kombëtar të Kosovës, menjëherë do të shfaqet edhe në festivalin e Gracit të Austrisë.

Ndërsa drejtori i kësaj trupe



Ahmet Brahimaj, përpos që u shpreh i lumtur për këtë pjesëmarrje, ai poashtu tha shumë fjalë të mira për koreografin Toulon, duke e vlerësuar atë shumë lartë. “Vetë fakti që kjo është hera e dytë që Dareli është këtu tregon faktin që ne kemi shumë përshtypje të mira për të dhe punën që e bënë. Përveç trupës së baletit atë e preokupon

edhe situata e Kosovës sepse ai qëndron me ne dhe informohet se çfarë ka ndodhur me secilin prej neve”, u shpreh ai. Shfaqja pritet të dalë me premierë me 15 qershor, dhe si projekt me kostumografi, skenografi, muzikë e të gjitha të tjerat do të kushtojë diku 31 mijë euro, pa llogaritur ndihmën që kanë marrë nga Culture for All dhe Ambasada e Austrisë në Prishtinë.



**KA NDËRRUAR
JETË NË MOSHËN
90-VJEÇARE
HISTORIANI I
NJOHUR GJERMAN,
FRIC SHTERN**

Lajmi u bë i njohur nga shtëpia e tij botuese në Mynih “C.H. Beck”, sipas së cilës Shtern ndërroi jetë në shtëpinë e tij, në Nju Jork

Ai ishte një nga historianët më të mëdhenj bashkëkohorë dhe kishte dhënë leksione edhe në Universitetin Kolumbia të Nju Jorkut, në Oksford dhe Prinstaun. Historiani u lind në Vroclav, Poloni, nga prindër hebrenj, të cilët u detyruan nga nazistët që të largoheshin nga Gjermania në vitin 1938. Nga ajo kohë ai jetoi përgjithmonë në Nju Jork, shkruan Koal.com. Ndër veprat e tij më të njohura janë “No ordinary men”, “Five Germanys I have known”, “Einstein’s german world”, “Gold and iron” dhe “The failure of illiberalism”.

Noel Malcolm do të shpallet Qytetar Nderi i Prizrenit

Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës ia ka dërguar Kuvendit të Komunës së Prizrenit propozimin që historiani e publicisti i njohur Noel Malcolm të shpallet Qytetar Nderi i Prizrenit.


Ky propozim pritet që të shqyrtohet gjatë kësaj jave në seancën plenare të KK të Prizrenit. Propozimi për këtë është adresuar nga kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Enver Hoxhaj, më 28 prill të këtij viti. “Kam kënaqësinë që në emër të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës t’ju propozoj që shkencëtarit, profesorit, historianit dhe publicistit të njohur ndërkombëtar, Sir Noel Malcolm, t’i ndahet mirënjohja ‘Qytetar Nderi i qytetit të Prizrenit’”, thuhet në shkresën e dërguar nga Hoxhaj. Në arsyetimin e këtij propozimi pohohet se kjo mirënjohje duhet t’i ndahet për kontributin e çmuar të tij në hulumtimet shkencore të historisë së shqiptarëve dhe çështjes së Kosovës, që tani është një aktivist i shquar i pavarësisë së Kosovës. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen Qytetar Nderi



të Noel Malcolm figuron në propozimin për rendin e ditës të seancës së radhës të KK-së, që do të mbahet këtë të enjte. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kujtim Gashi, ka konfirmuar për “Kohën Ditore” ndërmarrjen e veprimeve për ndarjen e kësaj mirënjohjeje për historianin Malcolm. Sipas tij, bëhet fjalë për iniciativën e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës që i është drejtuar kryetarit të Prizrenit, Ramadan

Muja, i cili më pas propozimin e ka proceduar në Kuvendin e Komunës. “Konsiderojmë se është nder për qytetin e Prizrenit që një personaliteti të tillë t’ia ndajmë këtë çmim, duke e ditur kontributin e tij në hulumtimet shkencore të historisë së shqiptarëve dhe çështjes së Kosovës, sidomos me librin ‘Kosova: Një histori e shkurtër’, sikurse edhe lobimin që ka bërë dhe e bën për pavarësinë e Kosovës”, ka thënë Gashi. Sipas tij, Malcolm është edhe autor i shumë artikujve në revista e gazeta prestigjioze, në të cilat Kosova paraqitet në mënyrë objektive para opinionit ndërkombëtar. Noel Malcolm, i lindur më 26 dhjetor 1956, është politikan, gazetar, historian dhe akademik

anglez. Ka doktoruar për histori në Trinity College, Cambridge. Ka ligjruar në Cambridge para se të niste punën si gazetar për çështje politike dhe punë të jashtme në “The Spectator” dhe “The Daily Telegraph”. Në vitin 1995 është larguar nga gazetaria për të nisur punën si shkrimtar dhe akademik. Në vitin 2014 i është ndarë titulli Sir për shërbimin në edukim, gazetari dhe në historinë evropiane. Është edhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si dhe anëtar nderi në Peterhouse (nga viti 2010) dhe Trinity College (nga viti 2011), Cambridge. Malcolm është autor i disa librave, në mesin e të cilëve bën pjesë edhe “Kosova: Një histori e shkurtër” e botuar në shqip në vitin 2008 nga Botimet KOHA. Ky libër ka ngjallur debat të madh në mesin e historianëve. Malcolm është kryesues i Institutit Boshnjak në Londër dhe kryetar i Shoqatës Anglo-Shqiptare.



HERONJTË

HISTORITË
E BURRAVE DHE GRAVE MË TË FAMSHME

Simon Sebag
Montefiore

55

JEWS IN THE CENTRAL STATE ARCHIVE

Prof. Dr. NEVILA NIKA
LILJANA VORPSI



ARCHIVAL
GUIDE BOOK

55

*"Një shprehje i shkurtruar për jetën përjetë të cilës është në Dhomë e shkurtruar...
Një pagjeturues i shkurtruar... Një sullojë e shkurtruar... Një shprehje e shkurtruar... Një shprehje e shkurtruar..."*

Simon Sebag Montefiore

Një natë dimri

55

Simon Sebag
MONTEFIORE

STALINI I RI

Fitues i çmimit "Costa Biography Award", 2007



55
Klipesha
Bretanese